

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
Nr. 5298 Aktit.  
1000lek.

Ka admim te tjere

5298

V E N D I M

" PËR RREGJISTRIM TË PERSONIT JURIDIK "

Sot, më datë 26.6.1993 në Gjykatën e Tiranës, unë Gjyqtar  
e kësaj Gjykate pasi u njoha me materjalin e paraqitur nga Giancarlo  
Mattazzi, Adu Allpere dhe Hajredin Zajmi për tu njohur si persona  
juridik të shoqëris së përbashkët:

K O N S T A T O V A

Se, kërkesa e tyre për të krijuar një shoqëri të përbashk  
ët të emërtuar " COCA - COLA BOTTLING ENTERPRISE TIRANA " sh.p.k.  
në prodhimin, përpunimin, shpërndarjen, shitjen e pijeve të ma-  
rkës Coca - cola Shqipëri është e drejtë dhe si e tillë duhet pranua

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 5 të Ligjës Nr. 7512 datë 10.8.1991

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik të shoqërisë " COCA - COLA  
BOTTLING ENTERPRISE TIRANA " sh.p.k të krijuar nga Giancarlo Matta-  
zzi, përfaqësues i shoqërisë Italjane Azienda Coerciali Industriali  
Estere dhe përfaqësuesi i shoqërisë Amerikane, Coca cola Export  
Corporation - Adu Allpere dhe Ndërmarrjes Invest P.F përfaqësuar nga  
Hajredin Zajmi, në prodhimin, përpunimin, shpërndarjen e shitjen e  
pijeve të markës coca - cola në Shqipëri.  
Kundër këtij vendimi lejohet ankim

GJYQTARI

Florina Tegu

Tiranë, 26.6.1993

Florina Tegu

GJYKATËS SË RRETHIT

TIRANË

5298

Me autorizimin nr. 53 datë 19.6.93 të Ministrisë së Tregëtisë Bashkëpunimit me Jashtë është miratuar kryerja e investimit në shoqërinë e përbashkët, për Coca-Cola Export Corporation (USA) dhe Azienda Comerciali Industriali Italiana Estere (Itali).

Shoqëria e përbashkët do të ketë emërtimin "Coca-Cola Bottling Enterprise Tirana LTD" me seli në Tiranë.

Objekti i shoqërisë do të jetë: prodhim, përpunim, shpërndarje e shitje të pijeve të markës Coca-Colënë Shqipëri.

Bashkalidhur është kontrata, statuti dhe autorizimi përkatës.

Lutemi, kryeni veprimet e nevojshme ligjore për regjistrimin e shoqërisë në gjykatë.

O R T A K Ë T T H E N D E S

A.S.I.S.

E.O.S.M.S.

Laveci F.P.

Fincaolo Cattazzi

Aadu Allpere

Hajredin Zajmi

700 200 intro het kerkese.  
29.06.1993  
7873

*[Handwritten signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DREJTORIA E STANDARDIZIMIT DHE CILESISE  
DEGA E STANDARDIZIMIT DHE KONTROLLIT TE CILESISE  
Nr. 24 Prot.

Tiranë, me 28.6 1993

LEJE Nr. 17

PER TREGUESIT CILESORE TE PRODHIMIT

Ne baze te ligjit Nr. 7630, date 28.10.1992 "Per Standardizimin e Cilesise" dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 4, date 2.12.1992 "Per fuqizimin e kontrollit per prodhimin, ruajtjen, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore", (neni 1, germa "ç"); mbeshtetur ne ekspertizat, analizat dhe dokumentet perkatese, Dega e Standardizimit dhe Kontrollit te Cilesise te rrethit \_\_\_\_\_

V E N D O S I:

1. Zetit Fabrika "Coca Cola", i jepet leje te prodhoj produktin (asortimentin) Pije freskuese "Coca Cola" sipas STRESH Nivelerkombitor ose parastandardit \_\_\_\_\_, apo deklarimeve te vete prodhuesit (sipas dokumentit te depozituar) ne kete dege.

2. Leja ka vlere vetem per prodhimin e asortimentit te siperpermendur.

KRYETARI I DEGES SE STANDARDIZIMIT  
DHE KONTROLLIT TE CILESISE SE RRETHIT



*[Handwritten signature]*

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT  
Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit  
Nr. 1111 Prot.

Tiranë, më 28.6.1993

L E J E nr. 45

Në bazë të V.A.M. nr 4 datë 2.12.1992 " Për fuqizimin e kontrollit për prodhimin, ruajtjen; transportimin dhe arëvatin e produkteve ushqimore" dhe të udhëzimit të Ministrit Bujqësisë dhe të Ushqimit nr38.datë24.2.1993, kjo Drejtori

V E N D O R T I :

shoqërisë " Coca-Cola Bottling Enterprise Tirane Ltd"(me seli në Tiranë tek pika e karburantit te kthesa e Kamzës) t'i jepet leja e aftësisë tekniko teknologjike për prodhim pijesh freskuese.



D R E J T O R I  
( Murçe Pipero )

*Murçe Pipero*

Shënim : Leja e nësipërme është e vlefshme për një periudhë  
1 (një) vjeçare nga data e dhënies dhe përsëritet çdo vit.

REPUBLIKA E SHQIPARISE

MINISTRIA E BUDZHETIT DHE UCHËSIMIT

Drejtoria e Budžetit dhe Uchëimit

Nr. ...144...Prot.


Tiranë, më 28.6.1992

LEJE nr. 46

Në bazë të V.K.L. nr 4, datë 2.12.1992 "Për fuqizimin e kontrolit për prodhimin; ruajtjen transportimin dhe tregtimin e produkteve uchiqimore" dhe të Uchëimit të Ministrisë së Budžetit dhe të Uchëimit nr.58 datë 24.2.1993, zjo drejtari

V E N D O S I :

Shoqërisë "Coca-Cola Bottling Enterprise Tirana LTD" (me seli në Tiranë në pikën e karburantit të kthesës e Kamzës ) t'i jepet leja e aktivitetit profesional për prodhim e pijeve freskuese.



Drejtori  
( Murçe Pipero )

*Murçe Pipero*

Shënim : Leja e mësipërme është e vlefshme për periudhë 1 ( një ) vjeçare nga data e dhënies dhe përsëritet çdo vit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E TREGTISE DHE BASHKEPUNIMIT  
EKONOMIK ME JAShte  
Drejtoria e Investimeve te Huaja dhe  
Teknologjise

A U T O R I Z I M

Nr. 53 Date 19.6.1993

Ne baze te kerkeses per te kryer investime ne territorin e Republikes se Shqiperise, te bere nga shoqeria italiane A.C.I.E, Aziende Commerciali Industriali Estere, me seli ne Bolonje-Itali dhe shoqeria amerikane T.C.C.E.C. The Coca-Cola Export Corporation, me seli Coca-Cola Plaza, Atlanta Georgia (U.S.A), Ministria e Tregtise dhe Bashkepunimit Ekonomik me Jashte,

A u t o r i z o n :

1. Lejimin e shoqerise italiane A.C.I.E, Aziende Commerciali Industriali Estere dhe shoqerise amerikane T.C.C.E.C. The Coca-Cola Export Corporation, me seli Coca-Cola Plaza, Atlanta Georgia (U.S.A), te investojne ne Tirane ne krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar "Coca-Cola Bottling Enterprise Tirana LTD", me ndermarrjen e "Invest PF" per te zhvilluar aktivitet ekonomik ne prodhimin, perpunimin, shperndarjen e shitjen e pijeve te markes Coca-Cola ne Republikën e Shqiperise.

2. Vlera qe do te investohet nga shoqeria italiane A.C.I.E, Aziende Commerciali Industriali Estere do te jete 7.050.000 US\$ dhe shoqeria amerikane T.C.C.E.C. The Coca-Cola Export Corporation do te jete 1.200.000 US\$; te dyja se bashku 8.250.000 US\$.



MINISTRI

*Artan HOXHA*

Artan HOXHA

Nr. 1340/ Prot.

Tirane, me 19.6. 1992

1905 ... VENTURE

...

... COLLEGE ...

... COLLEGE ...

...

...

... COLLEGE ...

## KONTRATE E JOINT VENTURE

### ndërmjet

**A.C.I.E** - Aziende Commerciali Industriali Estere (më poshtë e quajtur "Shoqëria italiane"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e ndërtuar në përputhje me legjislacionin italian, me ligjore në Bolonjë (Itali), përfaqësuar nga Mrs Maria Christina Elmi;

**COCA-COLA EXPORT CORPORATION** - (më poshtë e quajtur "Korporata"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e ndërtuar në përputhje me ligjet e shtetit të Delaware, SHBA, me seli ligjore në One Coca-Cola Plaza, Atlanta, Georgia, U.S.A., e përfaqësuar nga Z. Aadu J. Allpere;

### dhe

**INVEST PF** - (më poshtë e quajtur "Shoqëria shqiptare"), një shoqëri e ngritur rregullisht me vendimin 88, datë 26.8.1992, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli kryesore në Tiranë (Shqipëri), e përfaqësuar nga drejtori i saj, Z. Hajredin Zajmi.

### Meqenëse

- The Coca Cola Company (me poshte e quajtur "Kompania") është zotëruese markash tregtare botërisht të njohura të pijeve joalkoolike, të lëndëve bazë të tyre, të koncentrateve e shurupeve dhe është gjithashtu zotëruese markash të ndryshme tregtare që përbëhen nga konteinerë të dallueshëm të madhësive të ndryshme në të cilët pijet e saj janë tregtuar prej shumë vitesh si dhe e markave tregtare të përdorura në lidhje me reklamën dhe marketingun e pijeve të saj;
- Korporata është shoqëri e kontrolluar nga Kompania, e cila është prodhuesja kryesore



ne gjithë botën e koncentrateve dhe substancave bazë të pijeve joalkoolike të shitura nën markat e saj tregtare dhe ka një eksperiencë të gjerë në tërë aspektet e prodhimit, ambalazhimit, shpërndarjes dhe shitjes së pijeve të tilla në Europën Lindore;

Shoqëria shqiptare është një person juridik i formuar për qëllimin specifik të bashkëpunimit në shoqëri joint venture;

Shoqëria italiane është një shoqëri ortakë të së cilës janë A.C.I. (Aziende Commerciali S.p.A. - Itali) me seli në Bolonjë, SADIB dhe SIBEG, që janë shoqëri të grupit Busi, një grup i kompanive prodhuesve kryesorë të pijeve të ambalazuara në shishe me të cilin Kompania është e lidhur në Itali, me eksperiencë të madhe në drejtimin e fabrikave të prodhimit në shishe dhe në shpërndarjen e tregtimin e pijeve që mbajna markat e Kompanisë;

Shoqëria italiane, Korporata dhe Shoqëria shqiptare (në poshtë të quajtura "Palët") nëshpërndojnë të krijojnë në Shqipëri një joint venture aktiviteti kryesor i së cilës të jetë prodhimi, ambalazhimi, shpërndarja dhe shitja në territorin e Republikës së Shqipërisë e pijeve që të mbajna markat tregtare të Kompanisë;

për mënyrë një vendimi të saj të datës 5 Korrik 1992 (me pas i quajtur "Vendimi i Qeverisë së Shqipërisë") dhe në shkëmbimet kësaj kontrate. Në aneks A, qeveria shqiptare ka miratuar ligjin për investimet të huaja dhe ligjin për bashkëpunimet për investimet e huaja të cilat do të krijojnë një joint venture që do të shpërndojnë në Shqipëri si dhe prodhimin e të pijeve të cilat janë të nevojshme për prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të huaja që do të duhet të importohen e pastaj të prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë;

**ARTIKULLI I, PËR MËTO ARSYE, Palët, me anë të kësaj kontrate, merren vesh si më poshtë:**

Kontrata e kësaj kontrate e aneksat A, B, C, D, E, F, G e H konsiderohen pjesë përbërëse të kësaj kontrate. Nëse referencat e aneksatve për të cilëve ajo përbëhet janë vetëm për volla të Palëve dhe do të ndodhin në interkambimin e kësaj kontrate.

Kontrata do të kuptohet si kontratë e shitjes ose jarrësive ose shitësorë, që në kësaj kontrate është personi që prodhon, shpërndarë, shitësorë, kontraktues, kontraktues dhe prodhues të të gjitha produkteve të kësaj kontrate.

Kontrata do të kuptohet si kontratë e shitjes për të gjitha aneksat.

2.3 *Statut*: do të kuptohen drejtimet që lidhen me ndërtimin shoqërisë joint-venture dhe normat që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e saj. Statuti i bashkëlidhet Kontratës si aneks B.

2.4 *Pije*: do të kuptohen disa pije freskuese që mbajnë markat tregtare të Kompanisë, të cilat përshkruhen më hollësisht në Shtojcën I të Marrëveshjes mbi Prodhimin në Shishe.

2.5 *Lëndë bazë për pijet*: do të kuptohen disa koncentrate dhe substanca, formulat e të cilave përbëjnë sekrete industriale të Kompanisë dhe prej të cilave prodhohen më në fund Pijet.

2.6 *Marrëveshja për Prodhimin në Shishe*: do të kuptohet marrëveshja, duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe afatet e saj, kryesisht në formën që bashkëlidhet këtu si aneks C, në të cilën do të hyjnë Kompania dhe shoqëria joint venture dhe nëpërmjet të cilës Kompania do t'i japë shoqërisë joint venture të drejtën për të prodhuar, ambalazhuar, shpërndarë dhe shitur Pijet brenda një territori të veçantë të përcaktuar në të dhe në kushtet e preçizuar në të.

2.7 *Monedhë e konvertueshme*: do të kuptohet çdo monedhë me kurs zyrtar, e cila tregtohet lirisht në tregjet valutore ndërkombëtare dhe konvertohet lirisht në dollarë U.S.

2.8 *Investitorë të huaj*: do të kuptohen Shoqëria italiane dhe Korporata.

2.9 *Shoqëria Joint Venture*: do të kuptohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e formuar në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, duke përfshirë të tëra aneksat e saj, e me ligjin Nr.7638, dt 19.11.1992.

2.10 *Toka*: do të kuptohet një sipërfaqe prej 48000 metra katrorë, që ndodhet në Tiranë dhe paraqitet më saktësisht në planimetrinë që i bashkëlidhet kësaj Kontrate si aneks D.

2.11 *President i Këshillit Administrativ*: do të kete kuptimin e përcaktuar ne pikën 6.3 te kësaj Kontrate.

2.12 *Asambleja e Ortakëve*: kuptohet organi i përshkruar në pikën 6.2 të kësaj Kontrate.

2.13 *Këshilli Administrativ*: kuptohet organi i përshkruar në pikën 6.3 të kësaj Kontrate.

2.14 *Këshilli i Revizorëve*: kuptohet organi i përshkruar në pikën 6.5 të kësaj Kontrate.

2.15 *Territori*: kuptohet territori që përcaktohet në shtojcën II' të Marrëveshjes për Prodhimin me Shishe.

2.16 *U.S.D.*: do të kuptohet dollarë amerikanë.

2.17 *Palç ose Ortak(ë)*: kuptohen palët ose një prej palëve të kësaj Kontrate.

2.18 *Kontratë mbi transferimin e të drejtave të përdorimit të Tokës*: do të kuptohet kontrata të cilën do të nënshkruajnë Shoqëria shqiptare dhe Shoqëria Joint Venture, në

të njëjtën formë sikurse bashkëlidhet këtu si aneks G.

### 3. Shoqëria Joint Venture

3.1 Shoqëria Joint Venture do të formohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar, duke përfshirë Ligjin Nr.7638, dt.19.11.1992 dhe Vendimin e Qeverisë Shqiptare, si dhe të kësaj Kontrate së bashku me nenet e Statutit. Shoqëria do të fitojë statusin e një personi juridik të pavarur pasi të ketë plotësuar kërkesat e nevojshme për regjistrim sipas legjislacionit shqiptar. Dispozitat e Statutit do të interpretohen në përputhje me këtë Kontrate.

Gjatë gjithë afatit të kësaj Kontrate, Shoqëria Joint Venture do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet e aplikueshme shqiptare si dhe me dispozitat e kësaj Kontrate e të Statutit.

3.2 Emërtimi i Shoqërisë Joint Venture do të jetë "FABRIKA E PRODHIMIT COCA-COLA TIRANE Sh.p.k."

Shoqëria, menjëherë pas formimit të saj, do të nënshkruajë me Kompaninë Akt-marrëveshjen që parashikon kushtet specifike mbi bazë të të cilave ajo lejohet të përdorë markën e regjistruar "Coca-Cola" në emërtimin e saj. Një kopje e kësaj marrëveshjeje i bashkëlidhet kësaj Kontrate si aneks E.

3.3 Selia e regjistruar e Shoqërisë Joint Venture do të jetë në Tiranë.

3.4 Shoqëria Joint Venture mund të përfundojë kontrata me të tretë, me të drejtën që të bëhet pronare e të marrë detyrime drejt për së drejti dhe në interes të saj, të ngrejë padi dhe të paditet në gjyq e gjykata arbitrazhi, në Shqipëri e jashtë saj, si dhe të ngrejë filiale ndihmëse dhe agjensi në territor dhe jashtë.

Gjithë veprimtaria e Shoqërisë Joint Venture duhet të zhvillohet mbi bazën e kontratave tregtare.

3.5 Detyrimet e marra nga Shoqëria Joint Venture garantojnë vetëm nga kapitali i saj shoqëror dhe Palët do të jenë përgjegjëse për detyrimet e marra nga Shoqëria Joint Venture vetëm në masën e pjesëmarrjes së tyre efektive në kapitalin e kësaj shoqërie. Në asnjë rast pasuria e ortakëve të veçantë nuk mund t'i nënshtrohet përmbarimit të detyrueshëm në rast mosplotësimi nga Shoqëria Joint Venture të detyrimeve të marra prej saj.

3.6 Shoqëria Joint Venture do të jetë e pavarur, autonome dhe e vetadministruar; ajo do të mbajë librat e saj të llogarisë dhe llogaritë rrjedhëse bankare në emër të saj.

Llogaritë rrjedhëse në Monedhë të konvertueshme të Shoqërisë Joint Venture mund të përbëhen nga kontributet në para të pjesëmarrësve, nga valutë e konvertueshme e marrë hua nga Shoqëria Joint Venture dhe nga të ardhura të saj në

Monedhë të konvertueshme, duke përfshirë të ardhurat që dalin nga veprimtari këmbimi e nga transaksione të tjera kontraktuese që bëhen për të fituar Monedhë të konvertueshme.

3.7 Pasuria e Shoqërisë Joint Venture nuk mund t'i nënshtrohet asnjë shtetëzimi, shpronësimi e as çfarëdo lloj mase tjetër konfiskimi nga ana e qeverisë shqiptare ose e çfarëdo pale të tretë, siç është parashikuar në ligjin shqiptar nr.7496/92 mbi investimet e huaja.

Në rast se do të merren masa të tilla, ortakët e huaj duhet të marrin një zhdëmtim të menjëhershëm, të mjaftueshëm dhe efektiv, siç garantohet nga ligji shqiptar për investimet e huaja. Ky zhdëmtim, në çdo rast, nuk mund të jetë më i vogël se vlera e kësaj pasurie në çastin e derdhjes si kontribut në kapitalin shoqëror, e rivlerësuar në përputhje me ndryshimet e kursit të këmbimit ndërmjet U.S.D. dhe lekut, që kanë ndodhur në periudhën nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate në atë të pagesës efektive të zhdëmtimit.

3.8 Kohëzgjatja e Shoqërisë Joint Venture do të jetë 99 vjet, me të drejtë rizgjatjeje për 99 vjet të tjera, përveçse kur vërtetohen më parë fakte që çojnë në likuidim, zgjidhje e përfundim duke i bërë të porealizueshëm objektivat e synimet e kësaj Kontrate.

#### 4. Objektivat dhe synimet e Shoqërisë Joint Venture

4.1 Qëllimi kryesor i Shoqërisë Joint Venture do të jetë që të ushtrojë aktivitetet për prodhimin, ambalazhimin, shpërndarjen dhe shitjen e Pijeve të Kompanisë në Territor dhe të zhvillojë në maksimum rritjen fitimprurëse të këtij aktiviteti.

Shoqëria Joint Venture mund të merret edhe me prodhimin, ambalazhimin, shpërndarjen dhe shitjen e pijeve të tjera joalkoolike që mund të aprovohen herë pas here n. e shkrim nga Kompania (më pas të quajtura "Produkte të tjerë").

4.2 Shoqëria Joint Venture mund të ushtrojë veprimtaritë e mëposhtme të lidhura me objektivat themelore të treguara në 4.1:

4.2.1 Prodhimin dhe ambalazhimin e Pijeve dhe Produkteve të tjerë që mund të miratohen nga Kompania;

4.2.2 Tregtimin, shpërndarjen dhe shitjen e Pijeve dhe Produkteve të tjerë me Lekë dhe Monedhë të konvertueshme, sikurse lejohet nga legjislacioni shqiptar, brenda Territorit, në shishe qelqi të kthyeshme, kuti teneqeje, shishe plastike, në konteinerë post-mix e pre-mix, siç do të miratohet herë pas here me shkrim nga Kompania në bazë të Marrëveshjes për Prodhimin në Shishe.

4.2.3 Importimin prej Kompanisë ose furnitorëve të autorizuar prej saj, kundrejt pagesës në Monedhë të konvertueshme, të Lëndëve bazë për Pijet, të shurupeve dhe

Pijeve të gatshme, në kushtet e parashikuara në Marrëveshjen për prodhimin në Shishe dhe në marrëveshjen e veçantë për shpërndarjen që do të lidhet me Kompaninë.

4.2.4 Inportimin e lëndëve të para, materialeve të ndërtimit, pajisjeve, mjeteve të transportit, përbërësve, pjesëve të këmbimit dhe gjithë lëndëve të tjera ndihmëse që duhen për funksionimin ose për një zgjerim të mëtejshëm të Shoqërisë Joint Venture;

4.2.5 Prodhimin dhe shitjen e materialeve dhe aksesorëve që do të nevojiteshin për shitjen e Pijeve brenda Territorit.

4.2.6 Blerjen e ndërtesave dhe të të drejtave personale ose reale mbi sipërfaqet; ndërtimin, rinovimin, riparimin e ndërtesave dhe strukturave të tjera si edhe realizimin e ndryshimeve strukturore shtesë ose përmirësuese që mund të nevojiten në to; dhënien me qira e nënqira, hipotekinun, lënien peng, shitjen, transferimin, dhënien dhe kryerjen çdo akti tjetër që lidhet me ndërtesat apo me një pjesë të tyre ose me të drejtat reale ose personale të fituara mbi sipërfaqen, të bëra këto mbi bazë pagese në Monedhë të konvertueshme e në lekë, e gjitha kjo duke respektuar plotësisht kufijtë e parashikuara nga legjisllacioni shqiptar, përfshirë edhe Vendimin e Qeverisë shqiptare;

4.2.7 Pagesa, shkëmbime e veprimtari barter; shitje në eksport të mallrave shqiptare të blera në lekë nga fitimet e Shoqërisë Joint Venture si edhe pjesëmarrje në çdo lloj transaksioni të ligjshëm të kryer për të fituar Monedhë të konvertueshme që nevojitet për veprimtarinë e Shoqërisë Joint Venture, duke përfshirë pa kufizim të gjitha pagesat e kryera në bazë të Marrëveshjes për Prodhimin në shishe dhe të marrëveshjeve të tjera për importimin e Lëndëve bazë për Pijet, të ambalazhave e lëndëve të para të tjera;

4.2.8 Çdo aktivitet tjetër ndihmës dhe/ose të nevojshëm për arritjen e synimeve të Shoqërisë Joint Venture.

## **5. Kapitali i regjistruar dhe kontributet e Paleve**

5.1 Palet synojne te realizojne projektin e Joint Venture-it ne dy faza. Faza e pare do te jete do te jete formimi i Shoqerise Joint Venture me nje kapital fillestar te regjistruar prej 137.5000.000 lek, e barabarte me 1.250.000. U.S.D. ndersa faza e dyte do te jete rritje e kapitalit fillestar te Shoqerise Joint Venture me ekuivalentin ne lek te 8.250.000 U.S.D. sipas kursit te kembimit te aplikuar ne daten e miratimit te vendimit per rritjen e kapitalit, te bashkelidhur ketu si Aneks H.

5.2 Kapitali fillestar i regjistruar i Shoqerise Joint Venture do te jete 137.500.000. (njeqindetridhjeteshtate milion e peseqinmije) lek, i barabarte me 1.250.000. (nje milion e dyqindopesedhjetemije) U.S.D. dhe do te formohet nga kontributet ne para e ne natyre te Paleve si me poshte:

**SHOQERIA ITALIANE:**

kontribut ne para prej 640.000 (gjashtëqindëdyzetemije) U.S.D., e barabarte me 74.000.000 (shtatedhjetë milion e katërqindmije) lek.

#### KONTRATA:

kontribut ne para ne shumën prej 40.000 (dyzetemije) U.S.D., e barabarte me 4.400.000 (katër milion e katërqindmije) lek.

Kurri i këmbimit për kontributet ne U.S.D. do jete ai i aplikuar ne 5 Prill 1993, pra 110 U.S.D., sipas publikimit te Bankes se Shqiperise. Çdo ndryshim i mëvonshëm i raportin e këmbimit ndërmjet U.S.D. dhe lekut shqiptar nuk do të ketë asnjë efekt mbi përqindjet respektive të palëve në kapitalin shoqëror, që përcaktohen me poshte.

#### SHOQERIA SHQIPTARE

kontributi ne natyre i Shoqërise Shqiptare perbehet nga e drejta e kapituluar per te perdorimit per 99 (nentedhjetë) vjet një pjese Toke ne zonen e Tiranës, e caktuar per prodhimin e fabrikes se prodhimit ne shishe te Shoqërise Joint Venture. Palet kane rreze te tokes te vleresojne te drejten e perdorimit te Tokes ne 570.000 (peseqinde shtatedhjetë mijë) U.S.D., e barabarte me 62.700.000 (gjashtedhjetëdy milion e shtatedhjetë mijë) lek. Ky kusht i këmbimit te aplikuar ne 5 prill 1993, vleresim i cili eshte konfirmuar nga Komiteti i Arsyeshem nga Z.Agim Robo, jurist ne Ministrine e Bujqesise dhe Urdhresimit te Shqiptarëve, ne perputhje me nenin 42 te Ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992. Palet kane rreze te tokes te vleresojne ne aneksin F bashkelidhur. Shoqeria Shqiptare dhe Shoqeria Italiane, meqenëte mbas krijimit, do te nënshkruajne një "Kontrate mbi Transferimin e Drejtësisë te Perdorimit te Tokes", qe i bashkelidhet kesaj Kontrate si Aneksi G, me kushtin qe ciles te drejtat ekskluzive te perdorimit te Tokes do t'i kalojne Shoqërise Joint Venture ne pas kushteve te parashikuara ne te.

Shuma e total fillestar i Shoqërise Joint Venture prej 137.500.000 (peseqindëtrindjetëshate milion e peseqindmije) lek do te ndahet ne 137.500 kuota, me gjatësi vëre prej 1.000 lek secila, i ndare midis Paleve si me poshte:

Shoqeria Italiane:	70.400 kuota prej 1000 lek	= 51,2 per qind.
Shoqeria Shqiptare:	4.400 kuota prej 1000 lek	= 3,2 per qind.
Shoqeria Shqiptare	62.700 kuota prej 1000 lek	= 45,6 per qind.

3.3 Kontributet ne para te Paleve ne Monedhe te konvertueshme ne kapitalin fillestar te kompani do te depozitohen ne një llogari bankare te mbajtur ne emrin e Shoqërise Joint Venture ne një banke jashte Shqiperise, ne baze te një autorizimi te leshuar nga Banka Kombetare Tregtare e Shqiperise me daten 15 Prill 1993.

3.4 Palet garantojne qe kane te gjitha te drejtat e zoterimit dhe interesat mbi pasuritë

... dhe e jomateriale, te fundshme e patundshme qe ato do te kontribuojne ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise Joint Venture pavaresisht nga koha kur kontribuohen. Keto pasuri nuk i nenshtrohen asnje detyrimi hipotekor, obligacioni apo detyrimi tjetër. Me kalimin e ketyre pasurive Shoqerise Joint Venture, kjo e fundit do te kenaje ndaj Paleve kontribueses qe keto t'i transferojne Shoqerise Joint Venture te drejtat e zoterimit dhe interesat mbi to, te lira nga cdo detyrim tjetër, me kushtin e barre tjetër.

... detyrimet e palëve kontribuese te kryejne faze e dyte te projektit... Asamblene e Ortakeve te Shoqerise Joint Venture... 2.250.000... U.S.D., rrije e cila do te formohet nga... Shoqerise Italiane dhe Korporates, sipas... "Aneks H).

... te votohet brenda... (dymbardhëse) mund të... Shoqerise Joint Venture te gagjykatet... te vendosur... Shoqerise Joint Venture... te veprojte si ekspert vleresues i kont... ligji Nr.7638, dt. 19.11.1997... te kapitalit, mbajtja e kuotave do te...

... te shprehin detyrimin e tyre... Shoqerise Joint Venture mund te... Shoqerise Joint Venture te vendosin... te kryejne... te kryejne...

... te kryejne... Shoqerise Joint Venture... te kryejne... Shoqerise Joint Venture... te kryejne... Shoqerise Joint Venture... te kryejne...

6.1 Organet e Shoqërisë Joint Venture do të jenë: a) Asambleja e Ortakëve; b) Këshilli Administrativ dhe c) Këshilli i Revizorëve. Përbërja dhe funksionimi i këtyre organeve shoqërore dhe administrative paraqiten më hollësisht në Statut (Aneksi B).

#### 6.2 Asambleja e ortakëve

6.2.1 Asambleja e Ortakëve normalisht mbledhet në selinë e Shoqërisë Joint Venture, por mund të mbledhet gjithashtu diku tjetër, me kusht që vendi të jetë në Itali ose Austri.

Mbledhjet e Asamblesë janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhja e zakonshme duhet të thirret të paktën një herë në vit për të miratuar bilancin, brenda katër muajsh, ose, kur e lypin rrethana të jashtëzakonshme, brenda gjashtë muajsh nga mbyllja e vitit financiar.

Mbledhja thirret nga Këshilli i Administrativ me letër rekomande ose formë tjetër njoftimi që mban datë të caktuar, që u dërgohet Palëve në adresën që figuron në librin e ortakëve, të paktën pesëmbëdhjetë ditë para datës së caktuar për mbledhje. Në lajmërim duhen shënuar vendi, dita dhe ora e mbledhjes si edhe rendi i ditës. Edhe nëqoftëse ndonjë formalitet i mësipërm nuk është zbatuar, Asambleja quhet rregullisht e mbledhur kur në të përfaqsohet i gjithë kapitali shoqëror dhe marrin pjesë të gjithë antarët e Këshillit Administrativ e revizorët, si dhe kur ortakët pjesëmarrës kanë pranuar të marrin pjesë në mbledhjet në rendin e ditës.

Mbledhja kryesohet nga Presidenti i Shoqërisë ose, në mungesë të tij, nga Nënpresidenti, në rast se një i tillë është emëruar. Nëqoftëse kjo nuk është e mundur, atëherë mbledhja zgjedh Kryetarin e saj.

Presidenti i Asamblesë ndihmohet nga një sekretar i caktuar nga pjesëmarrësit, që mund të mos jetë ndër ortakët. Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje mund të përfaqësohet nga një person tjetër i autorizuar me shkrim, që mund të mos jetë ndër ortakët dhe që nuk duhet të jetë as administrator, as revizor e as i punësuar në Shoqëri Joint Venture.

6.2.2 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë ka të drejtë të marrë vendimet e zakonshme:

- a) të miratojë bilancin vjetor;
- b) të emetojë Këshillin Administrativ, revizorët dhe Presidentin e Këshillit të Ortakëve;
- c) të emetojë Presidentin e Këshillit Administrativ dhe, eventuale, Nënpresidentin;
- d) të caktojë sapërblimin e administratorëve e të revizorëve në rast se nuk është përcaktuar në Statut;
- e) të vendosë mbi përgjegjësitë e administratorëve dhe revizorëve;
- f) të vendosë mbi çdo çështje që ka të bëjë me drejtimin e Shoqërisë Joint Venture, siç është përcaktuar në Statut, është në kompetencë të mbledhjes së zakonshme të Asamblesë ose



që i paraqitet asaj për shqyrtim nga ana e Këshillit Administrativ.

6.2.3 Asambleja e jashtëzakonshme vendos mbi ndryshime të Statutit, vendos gjithashtu mbi likuidimin dhe emërimin e kompetencat e likuiduesve.

Ortakët që nuk pajtohen me vendimet që kanë të bëjnë me ndryshime të objektit apo tipit të shoqërisë kanë të drejtë të tërhiqen nga Shoqëria Joint Venture dhe të marrin pagesë për kuotën e tyre, në përpjestim me pasurinë e shoqërisë që rezulton nga bilanci i vitit të fundit financiar. Njoftimi për tërheqje duhet bërë për Shoqërinë Joint Venture me letër rekomande ose me formë tjetër komunikimi që mban datë zyrtarisht, brenda tre ditëve nga mbyllja e mbledhjes së Asamblesë, prej ortakëve që morrën pjesë në të dhe brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e regjistrimit të vendimit në përputhje me legjislacionin shqiptar, prej ortakëve që nuk morën pjesë në mbledhje.

6.2.4 Votat në mbledhjen e Asamblesë do të numërohen sipas parimit një kuotë - një votë.

6.2.5 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë miraton vendime me votën pozitive të ortakëve që përfaqësojnë shumicën absolute të kapitalit shoqëror. Mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë miraton vendime me votën pozitive të ortakëve që përfaqësojnë 3/4 e kapitalit shoqëror.

6.2.6 Protokollat e mbledhjes duhen mbajtur në shqip, italisht dhe anglisht, duhet të nënshtrohen nga Presidenti dhe nga sekretari i mbledhjes dhe përbejnë verbalet ligjore dhe efektive të mbledhjeve. Në rast mospërputhjeje ndërmjet versioneve të ndryshme të këtyre verbaleve, do të merret për bazë versioni italian.

### 6.3 Këshilli Administrativ

6.3.1 Këshilli Administrativ në fillim do të përbëhet nga pesë anëtarë me të drejtë vote (duke përfshirë Presidentin dhe Nënpresidentin); ky numër mund të ndryshohet në përshtatje me sa është parashikuar në Statut, duke garantuar që secila nga Palet do të ketë të drejtën të emërojë të paktën një anëtar në Këshillin Administrativ për sa kohë që ajo mban kuotë në Shoqërinë Joint Venture.

Ortaku maxhoritar (Shoqëria italiane) do të emërojë tre anëtarë; Shoqëria shqiptare do të emërojë një anëtar dhe po kaq edhe Korporata. Të gjitha këto emërimë duhet të miratohen nga Asambleja e Ortakëve. Këshilli Administrativ do të zgjedhë Presidentin dhe Nënpresidentin e tij. Të pesë anëtarët e Këshillit Administrativ duhet të emërohen nga Asambleja pas regjistrimit të Shoqërisë Joint Venture pranë organit kompetent shqiptar. Çdo anëtar i Këshillit Administrativ do të emërohet për një periudhë kohe të pacaktuar deri sa të mos jetë revokuar nga Asambleja e Ortakëve.

6.3.2 Këshilli Administrativ mund t'ia delegojë funksionet e veta njërit prej anëtarëve të

tij (administratori delegat),

duke përcaktuar kushtet e kësaj delegimi. Vendimet në lidhje me emërimin ose shkarkimin e Administratorit delegat duhet të regjistrohen pranë organit kompetent.

6.3 Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit Administrativ është e nevojshme praninë e shumicës së anëtarëve të tij në fuqi.

Styretë të vecante për vendimet që kanë të bëjnë me blerjen e shitjen ose me marrëdhëniet e biznesit apo një detyrë të veçantë të tij, si dhe për operacione financiare që shfaqin rrezikun më të lartë për qind të kapitalit të Shoqërisë Joint Venture, do të jepen me shumicë voto pozitive e katër administratorëve. Vendimet e Këshillit Administrativ merren me shumicë absolute. Vota nuk mund të jepet me përfaqësim.

#### 6.4 Administrata

Këshilli Administrativ mund t'ia delegojë funksionet e tij dhe Administratori delegat mund të emërojë dhe të shkarkojë Drejtorin përgjithshëm, edhe ky i emëruar nga Këshilli Administrativ.

Drejtori përgjithshëm i emëruar nga Drejtori i përgjithshëm, nën kontrollin e administratorit delegat, do të drejtojë veprimtarinë e përgjithshme të Shoqërisë Joint Venture në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm shqiptar, me dispozitat e kësaj Kontrate dhe me vendimet që do të merren nga Asambleja e Oritakëve dhe nga Këshilli Administrativ.

#### 6.5 Këshilli i Revizorëve

Këshilli i Revizorëve do të emërohet nga Asambleja e Oritakëve. Ai do të jetë i përbërë nga tre revizorë kontabël.

Këshilli i Revizorëve duhet të mbikëqyrë administrimin e Shoqërisë Joint Venture, të verifikojë aspektimin e ligjit dhe Statutit, të verifikojë meqenëse Këshilli i Revizorëve i Shoqërisë dhe në të kaluarë bilancin e Regjistrimit të Shoqërisë me rezultatet në të cilin regjistrat kontabël duhet të kontrollojë saktësinë e të dhënave të vendosura me ligjin dhe rregullat e pasura të Shoqërisë.

Për çdo kërkesë, Këshilli i Revizorëve duhet që, në përputhje me Statutin, të verifikojë gjendjen e arkës dhe të vlerësojë risajtje të praktikës shoqërore, apo të styretë të shërbimeve shoqërore në marrëje, paqë dhe shërbime.

Revizorët mund të procedojnë në çdo moment, edhe individualisht, me veprimet e kontrollit q vëzhgimit.

Këshilli i Revizorëve mund të kërkojë administratorëve njohitje mbi saktësinë e shërbimeve të Shoqërisë dhe të operacioneve të veçanta

Rezultatet e kontrolleve të bëra nga revizorët duhet të regjistrohen në librin e mbledhjeve e vendimeve të Këshillit të Revizorëve.

## **6.6 Rregulla përfundimtare**

6.6.1 Asambleja e Ortakëve, Këshilli Administrativ, Administratori delegat dhe Këshilli i Revizoreve duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të tillë që të respektojnë plotësisht parimet e zhvillimit të veprimtarisë së biznesit, të përfitimit reciprok dhe të mirëkuptimit e konsultimit miqësor.

6.6.2 Anëtarët e Asamblesë së Ortakëve e të Këshillit Administrativ mund të paguhen për shpenzimet e udhëtimit e shpenzime të tjera të kryera në mënyrë të arësyeshme për të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë e të Këshillit Administrativ, duke i paraqitur Shoqërisë dëftesat e nevojshme.

Përveç këtyre pagesave, as përfaqësuesit e Palëve në Asamblenë e Ortakëve e as zëvendësit e tyre nuk do të marrin nga Shoqëria Joint Venture asnjë shpërblim ose pagesë për detyrat e kryera në cilësitë e mësipërme. Anëtarët e Këshillit Administrativ mund të marrin shpërblime për shërbimet e kryera, në atë masë që do të caktohet nga Asambleja e Ortakëve.

6.6.3 Çdo ortak i Shoqërisë Joint Venture ka të drejtë të konsultohet me regjistrat e Shoqërisë dhe të ngarkojë, me shpenzimet e veta, një revizor për të kontrolluar librat e saj.

## **7. Veprimtaria financiare**

7.1 Në rast se Shoqëria Joint Venture do të kërkojë fonde financimi në çdo etapë të veprimtarisë së saj, vendimi mbi zgjedhjen e burimeve financiare dhe kushtet e financimit merret nga Këshilli Administrativ ose nga administratori delegat, në përputhje me klauzolat e mëparshme 6.3.2 e 6.3.3.

Me marrëveshje, asnjë nga Palët nuk do të jetë e detyruar të garantojë hua ose kredi për Shoqërinë Joint Venture, ose të marrë impenjime të tjera financiare në emër të Shoqërisë, përveç kontributeve të rëna dakort në kapital.

7.2 Për borxhet e marra për financim do të përgjigjet Shoqëria Joint Venture me pasuritë e saj.

## **8. Detyrime të Palëve**

8.1 Përveç detyrimeve të tjera të përcaktuara në Kontratë, Palët marrin përsipër edhe

detyrimet respektive që renditen më poshtë, në lidhje me organizimin dhe veprimtarinë e Shoqërisë Joint Venture.

8.2 Shoqëria italiane do të jetë përgjegjëse për çështjet e mëposhtme:

8.2.1 në mënyrë të vazhdueshme e të qëndrueshme, t'i sigurojë Shoqërisë Joint Venture konsulencë e mbështetje në lidhje me përmirësimin e zgjerimin e një sistemi modern prodhimi, shpërndarjeje, shitjeje e marketing-u;

8.2.2 të ndihmojë Shoqërinë Joint Venture në përgatitjen e funksionarëve administrativë e personelit tjetër në teknikën e drejtimit që lidhet me të gjitha aspektet e aktivitetit të kryer nga ajo;

8.2.3 të ndihmojë Shoqërinë Joint Venture në zgjedhjen e pajisjeve të nevojshme, në instalimin e fabrikës së prodhimit në shishe, në zgjedhjen e lëvruesve, në kontrollin cilësor të lëndëve të para e produktit të gatshëm si dhe në përmirësimin e teknikës së administrimit të fabrikës;

8.2.4 t'i japë Shoqërisë Joint Venture konsulencë e asistencë në organizimin e një training-u të përshtatshëm për të punësuarit e saj, duke përfshirë organizimin e kurseve të kualifikimit në Itali, kur kjo del e nevojshme;

8.2.5 të ndihmojë Shoqërinë Joint Venture për të gjetur burime të jashtme për sigurimin pajisjesh e lëndësh të para që nuk mund të gjenden në vend apo të importohet në lek;

8.2.6 të ndihmojë në të gjitha çështjet që bihet dakort t'i besohen nga Shoqëria Joint Venture.

8.3 Korporata do të jetë përgjegjëse për çështjet e mëposhtme:

8.3.1 të marrë përsipër të furnizojë teknologjinë e nevojshme për prodhimin e Pijeve dhe të kujdeset për komercializimin e prodhimeve të Shoqërisë Joint Venture;

8.3.2 në mënyrë të vazhdueshme e konstante, t'i sigurojë Shoqërisë Joint Venture konsulencë e mbështetje lidhur me përmirësimin dhe zgjerimin e një sistemi modern prodhimi, shpërndarjeje, shitjeje e marketing-u;

8.3.3 të ndihmojë Shoqërinë Joint Venture në zgjedhjen e pajisjeve të nevojshme, në instalimin e një fabrike për prodhimin në shishe, në zgjedhjen e lëvruesve, në kontrollin cilësor të lëndëve të para e produktit të gatshëm dhe në përmirësimin e teknikës së administrimit të fabrikës;

8.3.4 të ndihmojë në të gjitha çështjet që do të bihet dakort t'i besohen nga Shoqëria Joint Venture.

8.4 Shoqëria Shqiptare do të bëjë tërë përpjekjet e saj për të siguruar, në interes të Shoqërisë Joint Venture, sa më poshtë:

8.4.1 të gjitha autorizimet, miratimet e tjera e nevojshme që aktivitetit prodhues të Shoqërisë Joint Venture t'i sigurohet në kohë e vazhdimisht sasia e nevojshme e energjisë elektrike, avullit e të gjitha utilitetet, infrastruktura e shërbimet e nevojshme, siç

- çmimit të tregut në lek;
- 8.4.2 ndihmesë në përcaktimin gjeografik të rrjetit të furnizuesve;
- 8.4.3 të gjitha autorizimet e nevojshme për të hapur llogari rrjedhëse bankare në valutë të konvertueshme (U.S.D.) ose në lek pranë Bankës së Shqipërisë apo çfarëdo banke tjetër shqiptare në favor të Shoqërisë Joint Venture;
- 8.4.4 të gjitha vizat shqiptare, lejet e qendrimit, lejet e punës dhe vendbanime për punonjësit e huaj të Shoqërisë Joint Venture e anëtarët e familjeve të tyre që mund t'i shoqërojnë gjatë qendrimit në Shqipëri;
- 8.4.5 të bashkëpunojë në kerkimin e kandidatëve të kualifikuar shqiptarë për të punuar në Shoqërinë Joint Venture;
- 8.4.6 të gjithë ndihmesën e duhur, duke bashkëpunuar me Investitorët e huaj, për ekzekutimin e përpikë të të gjitha dispozitave të përcaktuara në Vendimin e Qeverisë shqiptare të datës 5.6.1993 dhe për të nxjerrë nga autoritetet kompetente shqiptare të gjitha lejet, autorizimet, licensat, lutjet dhe dokumenta të tjera për të cilat duhet miratim e regjistrim në Shqipëri, në lidhje me krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga ana e Shoqërisë Joint Venture;
- 8.4.7 ndihmesë në të gjitha çështjet e tjera që bihet dakort t'i besohen nga Shoqëria Joint Venture.
- 8.5 Shoqëria shqiptare do të bëjë tërë përpjekjet e saj për të siguruar që Shoqëria Joint Venture do t'i jepet me përparësi truallë prej 30.000 metra katrorë, i cili përcaktohet me qarte në ngjyrë të kuqe në planimetrinë aneks D, nëse Shoqëria Joint Venture e kërkon këtë truall për qëllimet e saj të prodhimit.

## 2.1 Llogaritë bankare dhe Monedha e konvertueshme

- 9.1 Shoqëria Joint Venture do t'i kryejë veprimet e tërheqjes së parave dhe pagesave lidhur me aktivitetet e saj përmes llogarish bankare në lek e Monedhë të konvertueshme me banka që kanë selinë në Shqipëri, ose përmes llogarish në Monedhë të konvertueshme me banka që kanë selinë jashtë Shqipërisë, sikurse do të miratohet nga Këshilli Administrativ dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar, duke përfshirë edhe Vendimin e Qeverisë Shqiptare.
- 9.2 Shoqëria Joint Venture do të depozitojë në llogarinë e saj në valutë të konvertueshme të gjitha shumat në Monedhë të konvertueshme që do të grumbullojë herë pas here. Bihet dakort midis Palëve që këto fonde në valutë të konvertueshme do të përdoren kryesisht për qëllimet e mëposhtme e sipas kësaj radhe përparësie:
- 9.2.1 pagesa për të mbuluar shpenzimet në Monedhë të konvertueshme (duke përfshirë,

për shërbull, pagesat për rogot e personelit të huaj, për shpenzime udhëtimi, për  
Mojca e Lëndëve bazë për Pijet) si dhe për pasivet eventuale të Shoqërisë Joint  
Venture;

TIRANE

2.1.1. transferimi pa vlerë juridike i pjesëve së fitimit që u takon investitorëve të huaj  
në këmbime pjesëmarrëse respektive si dhe i të ardhurave në rast likuidimi (sikurse  
përcaktohet nga Vendimi i Qeverisë Shqiptare);

2.1.2. pjesa e blonduhës së konvertueshme që mbetet do të përdoret sikurse do të  
përcaktohet nga administrata e doganave;

2.1.3. Shoqëria Joint Venture do të marrë pjesë në këmbime monetare dhe në çdo  
formë tjetër të këmbimit për të kryer riatdhesimin e kapitalit ose për të zhvendosur  
kapitalin e saj (në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në të, importimin e  
koncentratit të Lëndëve bazë të Pijave, lëndëve të përa, pajisjave, njejeve e pjesëve të  
tjera).

2.2. Taksat dhe kontribute

2.2.1. Shoqëria Joint Venture dhe Investitorët e huaj do të paguajnë taksat dhe kontribute  
në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës Shqiptare në tërësi të Qendrave të  
Taksave dhe Kontributeve të Shoqëria Joint Venture dhe investitorët e huaj do të paguajnë  
kontribute mbi llogaritë e mëposhteme:

2.2.1.1. Shoqëria Joint Venture dhe Investitorët e huaj do të përjashtohen nga taksat  
të importit dhe taksat e importit mbi makineritë, pajisjet, godinat e pambalancuara, taksat  
të importit e materiale të tjera, si kontribut në natyrë në kapitalin e Shoqërisë Joint  
Venture apo të bleira për kontributit në para.

2.2.1.2. Shoqëria Joint Venture dhe Investitorët e huaj do të përjashtohen nga taksat  
të importit e lëndëve bazë impurës dhe taksat e gacimeve të importuara përpara lëndëve  
të përpunuara të tilla si dhe nga taksat e taksat të prodhimit në mënyrë të njëjteshme për  
lëndë të përpunuara të tilla.

2.2.1.3. Shoqëria Joint Venture dhe Investitorët e huaj do të paguajnë dogenore e të importit mbi  
lëndë të përpunuara të tilla si dhe pajisjet e reze të tilla për periudha të tilla  
për të cilat gjerësitë e llogaritë të fitimit të prodhimit të saj

2.2.1.4. Shoqëria Joint Venture do të përjashtohet nga taksat mbi fitimin në llogaritë  
të tilla për periudha të tilla si dhe nga taksat e fitimit të prodhimit të saj, në përputhje me  
ligjin Nr. 7877, dt.9.11.1993.

2.3. Taksat dhe kontribute të tjera

2.3.1. Shoqëria Joint Venture do të paguajë taksat dhe kontribute të tilla si dhe kontribute të Shoqërisë Joint

Venture, nuk do të lejohet një ndarje e konsiderueshme fitimesh të paktën për pesë vjetët e parë të ekzistencës së saj. Për këtë arsye, fitimet do të përdoren për të financuar kryesisht zgjerimin e aktivitetit. Fitimet e Shoqërisë Joint Venture në lek e në Monedhë të konvertueshme mund të përdoren edhe për të kryer investime të reja në shoqëri të tjera që ekzistojnë në Shqipëri, për të blerë mallra e shërbime shqiptare ose mund t'u paguhen ortakëve në formën e dividendëve për kuotat e tyre, pas pesë vjetëve të parë të aktivitetit.

11.2 Sapo të bëhet e mundur ndarja e fitimeve neto, Shoqëria Joint Venture do kreditojë dividendët drejtpërdrejt në llogaritë e ortakëve, në mënyrë proporcionale me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë Joint Venture. Për Shoqërinë Italiane dhe Korporatën kredia do të jetë në U.S.D., sipas kursit të këmbimit në ditën e pagesës.

## 12. Punonjësit dhe marrëdhëniet në punë

12.1 Numri i përgjithshëm i punonjësve që do të merren në punë nga Shoqëria Joint Venture dhe kushtet e rrethanat e kontratave të punësimit të tyre i nënshtrohen vlerësimit të administratorit delegat. Pjesa më e madhe e punonjësve të Shoqërisë Joint Venture duhet të jenë të kombësisë shqiptare. Cdo kontrate kolektive do të kërkojë miratimin e Keshillit Administrativ.

12.2 Për punonjësit do të parashikohet një "training" i përshtatshëm, që do të kryhet në Shqipëri ose, në se gjykohet e nevojshme, jashtë saj.

12.3 Trajtimet siguruese si dhe ato që lidhen me sistemin e sigurimeve shoqërore në favor të punonjësve do të kryhen në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës shqiptar.

12.4 Në masën që nuk kundërshtohet nga legjislacioni shqiptar dhe në përputhje me sa parashikohet në kontratat respektive të punës, personeli i huaj do të ketë mundësinë të parapëlqejë për të përfituar të gjitha trajtimet e sigurimeve shoqërore jashtë Shqipërisë. Personel i huaj mund të marrë rrogë në Monedhë të konvertueshme.

## 13. Deklarime e garanci

13.1 Shoqëria shqiptare deklaron dhe i garanton Investitorët e huaj për sa më poshtë:

13.1.1 Shoqëria shqiptare është një person juridik i themeluar ligjërisht e që ekziston brenda rregullave, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Ajo ka të gjitha të drejtat e fuqitë për të nënshkruar këtë Kontratë e për të përmbushur detyrimet që përmbahen në të.

13.1.2 Kjo Kontratë është kryer nga përfaqësues ligjërisht të autorizuar të Shoqërisë

shqiptare dhe përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm e shtërngues të saj; Kontrata është detyruese në përputhje me klauzolat e saj dhe me dispozitat ligjore shqiptare.

**19.1.3** Kryerja dhe përmbushja e kësaj Kontrate nga ana e Shoqërisë shqiptare nuk përfshihet asnjë dispozitë të: (I) dokumentave të krijimit e të organizimit të Shoqërisë shqiptare; (II) çfarëdo kontrate apo dokumenti në të cilin Shoqëria shqiptare është një palë, ose, përmes të cilit, mund të angazhohet ndonjë pjesë e pasurive të saj; (III) çfarëdo detyrime të ligjeve, vendimeve, rregullave e urdhërësive të organeve qeveritare shqiptare, qendrore apo lokale, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë autoritet mbi Shoqërinë e Shoqërisë shqiptare.

**19.1.4** Shoqëria shqiptare ka të gjitha të drejtat e zotërimit dhe interesat mbi secilin nga pasuritë, të luajtshme e të paluajtshme, që përbëjnë kontributin e saj në natyrë në kapitalin e Shoqërisë Joint Venture. Këto pasuri nuk i nënshtrohen asnjë detyrimi hipotekor, interesi të tretësh apo çdo lloj barre tjetër. Me kalimin e këtyre pasurive në Shoqërinë Joint Venture, kjo e fundit do të ketë çdo të drejtë mbi to, sipas të njëjtës situatë të ligjore që do të zbatohet për palët e përfshira në Shoqërisë shqiptare.

**19.1.5** Të gjitha pasuritë e kësaj Shoqërie dhe të garantojnë Shoqërinë shqiptare në tërësi të plotë nga detyrimet e kësaj Shoqërie.

**19.1.6** Të gjitha kompanitë dhe Korporatat janë shoqëri të themeluara rregullisht e të regjistruara dhe funksionojnë respektivisht në përputhje me ligjet e Italisë e të Delaware (SHBA). Ata kanë të gjitha të drejtat e fuqisë ligjore për të nënshtkruar këtë Kontratë e për të përmbushur detyrimet që përmbahen në të.

**19.2.1** Kjo Kontratë është kryer nga përfaqësues ligjorë të autorizuar të Investitorëve të huaj që kanë marrë miratimet e nevojshme të këshillave administrative respektive dhe përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm e shtërngues për Investitorët e huaj.

**19.2.2** Zbatimi i përmbushja e kësaj Kontrate nga ana e Investitorëve të huaj nuk shpreh asnjë palë të përfaqësues të:

(I) dokumentave të krijimit e të organizimit të tyre; (II) çdo kontrate apo dokumenti në të cilin Investitorët e huaj janë palë apo përmes të cilit angazhohet ndonjë prej pasurive të tyre.

**19.2.3** Investitorët e huaj kanë të gjitha të drejtat e zotërimit e interesat mbi secilin prej pasurive, të luajtshme e të paluajtshme, që përbëjnë kontributin e tyre në natyrë në kapitalin e Shoqërisë Joint Venture. Këto pasuri nuk i nënshtrohen asnjë detyrimi hipotekor, interesi të tretësh apo çdo lloj barre tjetër. Me kalimin e këtyre pasurive në Shoqërinë Joint Venture, kjo e fundit do të ketë çdo të drejtë mbi to, sipas të njëjtës situatë të mesipërme zotërimit të tyre, që më parë i përkiste Investitorëve të huaj.



14.1. Të gjitha materialet e nevojshme për prodhimin e Pijeve duhet t'u përgjigjen kërkesave të marrëveshjes për Prodhimin në Shishe.

14.2. Shoqëri dhe ingredientët e tjerë të nevojshëm për prodhimin e Pijeve, si edhe etiketat e materialet e tjera ambalazhuese do të blihen brenda vendit, në varësi të mundësitë të standarteve cilësore të përcaktuara nga Kompania dhe të sigurimit të tyre në sasi të njëlloshme, në çmime konkurruese e kushte lëvrimi të bazuar në kontrata të gjalla furnizimi, të fletë, në të kundërt, Shoqëria Joint Venture do t'i importojë këto materialet.

15. Mbrojtja tregtare e Kompanisë

15.1. Prodhimi, ambalazhimi, shpërndarja dhe shitja e Pijeve nga ana e Shoqërisë Joint Venture do të kryhen në përputhje të plotë me dispozitat e Marrëveshjes për Prodhimin.

15.2. Kompania do të mbrojtë të gjitha të drejtat e Shoqërisë Joint Venture dhe Kompanisë në lidhje me:

(i) shenjat tregtare që i takojnë Shoqërisë Joint Venture e të cilat janë:

(a) shenjat tregtare të shprehura apo zotërimin mbi markat tregtare të shprehura apo privilegjet tregtare që lidhen me të, mbi shenjat dalluese, dizeneje, emblemat, etiketat, kontejnerët e çdo simbol tjetër vizual që përdoret në lidhje me produktet e kësaj Kontrate. Këto marka tregtare, etiketa, shenja dalluese, dizeneje,

(b) shenjat tregtare të tjera vizuale mund vetëm të përdoren nga ana e Shoqërisë Joint Venture në përputhje me një lejeje të përkohëshme që i akordohet asaj të përputhje me

dispozitat e Marrëveshjes për Prodhimin në Shishe.

16. Përfundim dhe marrëdhënie të tregëtisë

16.1. Palët sigurojnë që sistemi i prodhimit e shpërndarjes i Shoqërisë Joint Venture do të jetë i tërësishëm dhe do të bëjë vetëm një Pijet, prodhimin e shpërndarjen e çdo lloj produkti tjetër do të kryhet nën autorizimin e shprehur të Kompanisë.

16.2. Pavarësisht nga sa në sipër, Shoqëria shqiptare e çdo shoqëri tregëtare do të sigurojë

16.3. Kompania do të sigurojë periudhën e mbledhjes së kësaj Kontrate dhe për një vit pas saj, nuk do të kryjë në: (i) asnjë kontratë për joint venture, apo marrëveshje të ngjashme, me çdo lloj shoqëri ndërkombëtare të pijeve freskuese, që ka të bëjë me krijimin në Shqipëri të një kompanie të bashkëpunimit me aktivitet prodhimin, komercializimin, shpërndarjen e shitjen e pijeve joalkoolike apo produkteve premixed e postmixuara; (ii) asnjë kontratë me ndonjë shoqëri ndërkombëtare pijeve freskuese apo ilaçe të saj, lidhur me importimin,

prodhimin, ambalazhimin, shpërndarjen ose nxitjen e pijeve freskuese apo çdo produkti tjetër konkurrues me ata që trajton drejtpërdrejt Shoqëria Joint Venture, pa miratimin paraprak me shkrim të Kompanisë.

### 17. Fshehtësia

17.1 Informacioni sekret, duke përfshirë, pa përjashtim, të dhëna financiare, teknike e të shitjes, sekrete tregtare, kërkesa patente, know-how e lidhur me patenta apo kërkesa patente, shpikje, përmirësime, zbulime, procese prodhimi, procedura e metoda, regjistra të dhënash, formula, projekte, vizatime, skica, specifikime, fakte administrative e tregtare që i përkasin njëres prej Palëve ose klientëve, produkteve, furnitorëve apo ortakëve të saj, që bëhen të njohura nga një Palë ("Transferuesi") për tjetrën ose për Shoqërinë Joint Venture do të përdoren vetëm për qëllimet e vetë aktivitetit të Shoqërisë Joint Venture. Asnjëra prej Palëve nuk do të jetë e detyruar t'i emërtojë informacionet sekrete shprehimisht si të tilla. Mostregimi si i tillë i karakterit sekret të një informacioni nuk mund të pengojë zbatimin e kësaj pike 17 të Kontratës.

54.2 The dividends left uncollected for five (5) years from the due date will be returned to the Company.

### DISSOLUTION


#### Article 55

55.1 The Company is dissolved:

- (a) at the expiration of the term set by the Shareholders;
- (b) on accomplishment of the Company's object, or in case of impossibility of such accomplishment;
- (c) in case of circumstances preventing the Company from functioning or in case of prolonged inactivity of the Shareholders' meeting;
- (d) in case the entire capital is lost with the exception of the cases mentioned in previous article 9;
- (e) following resolution by the Shareholders' meeting.

#### Article 56

56.1 When a situation leading to dissolution of the Company occurs, the Directors must call a meeting within thirty (30) days in order to define the procedure for the dissolution. In addition, they must nominate one or more liquidators, who are not required to be Shareholders, and define their role and fees.

 Maria Cristina



## Article 57

57.1 During the period of liquidation, the provisions regulating the meeting and the Board of Auditors are applied, if compatible.

## Article 58

58.1 Once the dissolution has been performed, the liquidators must draw up the final balance sheet indicating the amount due to each shareholder from the division of the profits.

GENERAL PROVISIONS

## Article 59




59.1 For all matters not expressly covered by the present By-Laws, Albanian law shall apply, or in absence of provisions of Albanian law, the Italian civil code, and in particular the provisions regulating corporations and limited liability companies shall apply (art 2472-2497). Reference to such regulations must be made in order to interpret and integrate the clauses included in the present By-Laws.

ARBITRATION CLAUSE

## Article 60

60.1 All disputes arising in connection with the present contract shall be finally settled under the Rules of Conciliation and Arbitration of the International Chamber of Commerce by one or more arbitrators appointed in accordance with the said rules. Notwithstanding anything herein to the contrary, no provision of this Agreement shall be construed as a waiver by the European Bank of any of the immunities, privileges, and exemptions granted to the European Bank under the Agreement Establishing the European Bank for Reconstruction and Development and applicable law.

60.2 The arbitration shall take place in Milan and the arbitrators shall decide upon the controlling language of the arbitral proceeding.

 Maria Cristina Elmi  
  




30.2 Kjo Kontrate , së bashku me anekset e saj , përben një mirkuptim të plotë ndërmjet Paleve në lidhje me Objektin që përmban dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme , me shkrim apo me gojë , midis tyre , në lidhje me të njëjtin objekt.

30.3 Shtesa dhe /ose modifikime të kësaj Kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen rregullisht nga përfaqësues të autorizuar të Paleve.



30.4 Mosarritja e ndonjë prej Paleve të kësaj Kontrate për të insistuar në zbatimin rigoroz të ndonjë dispozite të saj nuk do të kuptohet si heqje dore nga e drejta për të kërkuar një zbatim të tillë e as nga e drejta për të kërkuar çdo zbatim tjetër të një natyre të ngjashme ose jo.

30.5 Nëse një apo më shumë dispozita të kësaj Kontrate do të jenë të pavlefshme , jolegjitime apo të pazbatueshme në një aspekt çfarëdo , kjo nuk do të ndikojë ose dobësojë në asnjë mënyrë vlefshmërinë , legjitimitetin dhe zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të saj , duke pranuar që , sidoqoftë, në një rast të tillë , Palet do të bëjnë ç'është e mundur që të arrijnë qëllimin e dispozites së pavlefshme nëpërmjet një dispozite të re , ligjrisht të vlefshme.

30.6 Asgjë që përmbahet në këtë Kontrate nuk mund të përdoret për të autorizuar njerëz nga Palet që të veprojnë si agjente për Palet e tjera ose për të lejuar njerëz nga Palet që të marrë përsipër detyrime të Paleve të tjera.

30.7 Kjo Kontrate përbehet nga 28<sup>6</sup> faqe duke përjashtuar anekset.





# **KONTRATE E JOINT VENTURE**

**NDERMJET**

**THE COCA - COLA EXPORT CORPORATION ( SHBA )**

**A.C.I.E. AZIENDE COMMERCIALI INDUSTRIALI ESTERE ( ITALI )**

**DHE**

**INVEST P.F. ( SHQIPERI )**

**PER PRODHIMIN , AMBALLAZHIMIN DHE SHITJEN E PIJEVE  
JOALKOOLIKE**

**NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE**



## KONTRATE E JOINT VENTURE

### ndermjet

A.C.I.E - Aziende Commerciali Industriali Estere (me poshte e quajtur "Shoqeria italiane ose A.C.I.E."), nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e ndertuar ne perputhje me legjislacionin italian, me seli ligjore ne Bolonje (Itali), e perfaqesuar nga Presidenti ,Znj. Maria Cristina Elmi;

COCA-COLA EXPORT CORPORATION - T.C.C.E.C. ,(me poshte e quajtur "Korporata" ), nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e ndertuar ne perputhje me ligjet e shtetit te Delaware, Sh.B.A., me seli ligjore ne One Coca-Cola Plaza, Atlanta, Georgia, U.S.A., e perfaqesuar nga Z. Aadu J. Allpere;

INVEST PF -(me poshte e quajtur "Shoqeria shqiptare"), nje shoqeri e ngritur rregullisht me vendimin 88, date 26.08.1992, ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, me seli kryesore ne Tirane (Shqiperi), e perfaqesuar nga drejtori i saj, Z. Hajredin Zajmi ;

### dhe

B.E.R.ZH- Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim , perfaqesuar nga Z. Simon J. Alberga .

### Meqenese

- The Coca Cola Company (me poshte e quajtur "Kompania") eshte zoteruese markash tregtare boterisht te njohura te pijeve joalkolike, te lendeve baze te tyre, te koncentrateve e shurupeve dhe eshte gjithashtu zoteruese markash te ndryshme tregtare qe perbehen nga konteinere te dallueshem te madhesive te ndryshme ne te cilet pijet e saj jane tregtuar prej shume vitesh si dhe e markave tregtare te perdorura ne lidhje me reklamen dhe marketingun e pijeve te saj;
- Korporata eshte shoqeri e kontrolluar nga Kompania , e cila eshte prodhuesja kryesore ne gjithë boten e koncentrateve dhe substancave baze te pijeve joalkolike te shitura nen markat e saj tregtare dhe ka nje eksperience te gjere ne tere aspektet e prodhimit, ambalazhimit, shperndarjes dhe shitjes se pijeve te tilla ne Europen Lindore;

- Shoqeria shqiptare eshte nje person juridik i formuar per qellimin specifik te pjesmarjes ne shoqerine joint venture;
- Shoqeria italiane eshte nje shoqeri ortake te se ciles jane A.C.I. (Aziende Commerciali Industriali) me seli ne Bolonje, SADIB dhe SIBEG, qe jane shoqeri te grupit Busi, nje prej prodhuesve kryesore te pijeve te ambalazuara ne shishe me te cilin Kompania vepron ne Itali, me eksperience te madhe ne drejtimin e fabrikave te prodhimit ne shishe si dhe ne shperndarjen e tregtimin e pijeve qe mbajne markat e Kompanise;
- Shoqeria italiane, Korporata dhe Shoqeria shqiptare (me poshte te quajtura "Palet") deshirojne te krijojne ne Shqiperi nje joint venture aktiviteti kryesor i se ciles te jete prodhimi, ambalazhimi, shperndarja dhe shitja ne territorin e Republikes se Shqiperise e pijeve qe mbajne markat tregtare te Kompanise;
- permes nje vendimi te saj te dates 5 korrik 1992 (me pas i quajtur "Vendim i Qeverise Shqiptare"), qe i bashkelidhet kesaj kontrate si aneks A, qeveria shqiptare ka miratuar projektin e joint venture-it dhe ka dhene disa garanci per investimet e ortakeve te tij lidhur me shoqerine joint venture qe do te krijohet ne Shqiperi si dhe per leshimin e te gjitha autorizimeve qeveritare te nevojshme per prodhimin, shitjen dhe shperndarjen e produkteve fillestare qe do te duhet te importohen e pastaj te prodhohen ne territorin e Republikes se Shqiperise;

**ATEHERE, PER KETO ARSYE, Palet, me ane te kesaj kontrate, merren vesh si me poshte:**

### 1.Parashtese

Te gjitha hyrjet e anekset A,B,C,D,E,F,G e H konsiderohen pjese perberese te kesaj kontrate. Titujt e paragrafeve prej te cileve ajo perbehet jane vetem per voline e Paleve dhe nuk do te ndikojne ne interpretimin e vete kontrates.

### 2.Percaktime

2.1 Filiale: do te kuptohet çdo person fizik ose juridik, privat ose shtetëror, qe, ne raport me nje person tjetër fizik ose juridik, privat ose shtetëror, kontrollon, kontrollohet prej, ose eshte nen te njejtin kontroll me kete te fundit.

2.2 Kontrate : do te kuptohet kjo kontrate duke perfshire te gjitha anekset.

2.3 Statut : do te kuptohen dispozitat qe lidhen me ndertimin e shoqerise joint-venture dhe normat qe kane te bejne me organizimin dhe aktivitetin e saj. Statuti i bashkelidhet Kontrates si aneks B.

2.4 Pije : do te kuptohen disa pije freskuese qe mbajne markat tregtare te Kompanise, te cilat pershkruhen me hollesisht ne Shtojcen I te Marreveshjes mbi Prodhimin ne Shishe .

2.5.Lende baze per pijet : do te kuptohen disa koncentrate dhe substanca , formulat e te cilave perbejne sekrete industriale te Kompanise dhe prej te cilave prodhohen me ne fund Pijet .



2.6. Marreveshja per Prodhimin ne Shishe : do te kuptohet marreveshja duke perfshire te gjitha shtojcat dhe afatet e saj , kryesishi ne formen qe bashkelidhet ketu si aneks C , ne te cilen do te hyne Kompania dhe shoqeria joint - venture dhe nepermjet te ciles Kompania do t'i jape shoqerise joint - venture te drejten per te prodhuar , ambalazhuar , shpermdare dhe shitur Pijet brenda nje territori te veçante te percaktuar ne te dhe ne kushtet e preçizuar ne te .

2.7. Monedhe e konvertueshme : do te kuptohet çdo monedhe , e cila tregtohet lirisht ne tregjet valutore nderkombetare dhe konvertohet lirisht ne dollare US .

2.8. Investitore te huaj : do te kuptohen Shoqeria italiane dhe Korporata .

2.9. Shoqeria Joint - Venture : do te kuptohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e formuar ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate duke perfshire te tera anekset e saj , e me ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 .

2.10 .Toka : do te kuptohet nje siperfaqe prej 48.000 mije , qe ndodhet ne Tirane dhe paraqitet me saktesisht ne planimetrine qe i bashkelidhet kesaj Kontrate si aneks D .

2.11. President i Keshillit Administrativ : do te kete kuptimin e percaktuar ne piken 6.3 te kesaj Kontrate .

2.12. Asambleja e Ortakeve : kuptohet organi i pershkruar ne piken 6.2. te kesaj Kontrate .

2.13. Keshilli Administrativ : kuptohet organi i pershkruar ne piken 6.3 te kesaj Kontrate.

2.14. Keshilli i Revizoreve : kuptohet organi i pershkruar ne piken 6.5. te kesaj Kontrate .

2.15. Territor : kuptohet territori qe percaktohet ne shtojcen III te Marreveshjes per Prodhimin me Shishe .

2.16. USD : do te kuptohet dollare amerikane .

2.17. Pale ose Ortak ( e ) : kuptohen palet ose nje prej paleve te kesaj Kontrate .

2.18. Kontrate mbi transferimin e te drejtave te perdorimit te Tokes : do te kuptohet kontrata te cilen do ta neneshkruajne Shoqeria shqiptare dhe Shoqeria Joint - Venture , ne te njejten forme sikurse bashkelidhet ketu si aneks G .

### 3. Shoqeria e Joint Venture

3.1. Shoqeria e Joint Venture do te formohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar, duke perfshire Ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 dhe Vendimin e Qeverise Shqiptare, si dhe te kesaj Kontrate se bashku me nenet e Statutit. Shoqeria do te fitoje statusin e nje personi juridik te pavarur pasi te kete plotesuar kerkesat e nevojshme per regjistrimin sipas legjislacionit shqiptar. Dispozitat e Statutit do te hartohen ne perputhje me kete Kontrate.



Gjate gjithë afatit të kësaj Kontrate, Shoqëria Joint-Venture do të ushtroje veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet e aplikueshme shqiptare si dhe me dispozitat e kësaj Kontrate e të Statutit.

3.2 Emerimi i Shoqërisë Joint-Venture do të jetë "FABRIKA E PRODHIMIT COCA-COLA TIRANE Sh.p.k."

Shoqëria, menjëherë pas formimit të saj, do të nënshkruajë me Kompaninë Akt - marreveshjen që parashikon kushtet specifike mbi baze të cilave ajo lejohet të përdorë marken e regjistruar "Coca-Cola" në emerimin e saj. Një kopje e kësaj marreveshjeje i bashkelidhet kësaj Kontrate si aneks E.

3.3 Selia e regjistruar e Shoqërisë Joint-Venture do të jetë në Tiranë.

3.4 Shoqëria e Joint Venture - it do të ketë autorizimin e plote për të hyrë në transaksione legale me palet e treta, me të drejtën që të bëhet pronarë e të marrë detyrime drejt për se drejti e në interes të saj, të ngrejë padi e të paditet sipas juridiksionit, në arbitrazhe ose jo, në Shqipëri e jashtë saj, si dhe të ngrejë dege, zyra e përfaqësi në Territor dhe jashtë. Gjithë veprimtaria e Shoqërisë Joint Venture duhet të zhvillohet mbi bazën e kontratave tregëtare.

3.5 Detyrimet e marra nga Shoqëria Joint-Venture garantojnë vetëm nga kapitali i saj shoqëror dhe Palet do të jenë përgjegjëse për detyrimet e marra nga Shoqëria Joint-Venture vetëm në masën e pjesëmarrjes së tyre efektive në kapitalin e kësaj shoqërie. Në asnjë rast pasuria e ortakëve të veçantë nuk mund t'i nënshtrohet përmbartimit të detyrueshëm në rast mosplotësimi nga Shoqëria Joint-Venture të detyrimeve të marra prej saj.

3.6 Shoqëria Joint-Venture do të jetë e pavarur, autonome dhe e vetadministruar, ajo do të mbajë librat e saj të llogarive dhe llogaritë rrjedhese bankare në emer të saj.

Llogaritë rrjedhese në Monedhe të konvertueshme të Shoqërisë Joint-Venture mund të përbehen nga kontributet në para të pjesëmarrësve, nga valute e konvertueshme e marre hua nga Shoqëria Joint-Venture dhe nga të ardhurat e saj në Monedhe të konvertueshme, duke përfshirë të ardhurat që dalin nga veprimtaria kembimi e nga transaksione të tjera kontraktuese që behen për të fituar Monedhe të konvertueshme.

3.7 Pasuria e Shoqërisë Joint-Venture nuk mund t'i nënshtrohet asnjë shtetëzimi, shpronësimi e as çfarëdo lloj mase tjetër konfiskimi nga ana e qeverisë shqiptare ose e çfarëdo pale të treta, siç është parashikuar në ligjin shqiptar nr. 7496/92 mbi investimet e huaja.

Në rast se do të merren masa të tilla, investitorët e huaj dhe B.E.R.ZH. duhet të marrin një zhdëmtim të menjëhershëm, të mjaftueshëm dhe efektiv, siç garantohet nga ligji shqiptar për investimet e huaja. Ky zhdëmtim, në çdo rast, nuk mund të jetë më i vogël se vlera e kësaj pasurie në çastin e derdhjes së kontributit në kapitalin shoqëror, e rivlerësuar në përputhje me ndryshimet e kursit të kembimit ndërmjet U.S.D. dhe lekut, që kanë ndodhur në periudhën nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate në atë të pagesës efektive të zhdëmtimit.

3.8 Kohe zgjatja e Shoqërisë Joint-Venture do të jetë 99 vjet, me të drejtë rizgjatje për 99 vjet të tjera, përveçse kur vërtetohen me pare fakte që çojnë në likuidim, zgjidhje e përfundim duke i bërë të paralizueshme objektivat e synimet e kësaj Kontrate.







#### 4. Objektivat dhe synimet e Shoqerise Joint-Venture

4.1 Qellimi kryesor i Shoqerise Joint-Venture do te jete qe te ushtroje aktivitet per prodhimin, ambalazhimin, shperndarjen dhe shitjen e Pijeve te Kompanise ne Territor dhe te zhvilloje ne maksimumin shitjen fitimpruresse te ketij aktiviteti.

Shoqeria Joint-Venture mund te merret edhe me prodhimin, ambalazhimin, shperndarjen dhe shitjen e pijeve te tjera joalkolike qe mund te aprovohen here pas here me shkrim nga Kompania (me pas te quajtura "Produkte te tjere").

4.2 Shoqeria Joint-Venture mund te ushtroje veprimtarite e meposhtme te lidhura me objektivat themelore te treguara ne 4.1:

4.2.1 Prodhimin dhe ambalazhimin e Pijeve dhe Produkteve te tjere qe mund te miratohen nga Kompania;

4.2.2 Tregtimin, shperndarjen dhe shitjen e Pijeve dhe Produkteve te tjere me Leke dhe Monedhe te konvertueshme, sikurse lejohet nga legjislacioni shqiptar, brenda Territorit, ne shishe qelqi te kthyeshme, kuti teneqeje, shishe plastike, ne konteinere post-mix e pre-mix, siç do te miratohet here pas here me shkrim nga Kompania ne baze te Marreveshjes per Prodhimin ne Shishe.

4.2.3 Importimin prej Kompanise ose furnitoreve te autorizuar prej saj, kundrejt pageses ne Monedhe te konvertueshme, te Lendeve baze per Pijet, te shurubeve dhe Pijeve te gatshme, ne kushtet e parashikuara ne Marreveshjen per prodhimin ne Shishe dhe ne marreveshjen e veçante per shperndarjen qe do te lidhet me Kompanine.

4.2.4 Importimin e lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, mjeteve te transportit, perberesve, pjeseve te kembimit dhe gjithë lendeve te tjera ndihmese qe duhen per funksionimin ose per nje zgjerim te metejshem te Shoqerise Joint-Venture;

4.2.5 Prodhimin dhe shitjen e materialeve dhe aksesoreve qe do te nevojiteshin per shitjen e Pijeve brenda Territorit.

4.2.6 Blerjen e ndertesave dhe te drejtave personale ose reale mbi sipërfaqet; ndertimin, rinovimin, riparimin e ndertesave dhe strukturave te tjera si edhe realizimin e ndryshimeve strukturore shtese ose permiresuese qe mund te nevojiten ne to; dhenien me qera e nenqera, hipotekimin, lenien peng, shitjen, transferimin, dhenien dhe/ose kryerjen çdo akti tjetër qe lidhet me ndertesat apo me nje pjese te tyre ose me te drejtat reale ose personale te fituara mbi sipërfaqen, te bera keto mbi baze pagese ne Monedhe te konvertueshme e ne leke, e gjitha kjo duke respektuar plotesisht kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar, perfshire edhe Vendimin e Qeverise shqiptare;

4.2.7 Pagesa, shkembime e veprimtari barter, shitje ne eksport te mallrave shqiptare te blera ne leke nga fitimet e Shoqerise Joint-Venture si edhe pjesemarrje ne çdo lloj transaksioni te ligjshem te kryer per te fituar Monedhe te konvertueshme qe nevojitet per veprimtarine e Shoqerise Joint-Venture, duke perfshire pa kufizim te gjitha pagesat e kryera ne baze te







Marreveshjes per Prodhimin ne shishe dhe te marreveshjeve te tjera per importimin e Lendeve baze per Pijet, te ambalazheve e lendeve te para te tjera;

4.2.8 Çdo aktivitet tjeter ndihmes dhe /ose te nevojshem per arritjen e synimeve te Shoqerise Joint-Venture.

### 5. Kapitali i regjistruar dhe kontributet e Paleve

5.1 Palet synojne te realizojne projektin e Joint-Venture-it ne dy faza, e para permes formimit te kapitalit fillestar te Shoqerise se Joint-Venture-it me nje shume prej 137.500.000 lek e barabarte me 1.250.000 USD, dhe e dyta permes shtimit te kapitalit shoqeror fillestar te Shoqerise se Joint-Venture me nje shume te barabarte me ekuivalentin ne lek te 8.250.000 USD me kursin e kembimit te aplikuar ne 5 prill 1993 siç specifikohet ne piken 5.2.

5.2 Kapitali fillestar i regjistruar i Shoqerise Joint-Venture do te jete 137.500.000. (njeqind e tridhjet e shtate milion e peseqindmije) lek, i barabarte me 1.250.000. (nje milion e dyqind e pesedhjetete mije) U.S.D. dhe do te formohet nga kontributet ne para e ne natyre te Paleve si me poshte:

#### SHOQERIA ITALIANE

-kontribut ne para prej 640.000 (gjashteqindedyzetemije) U.S.D., e barabarte me 70.400.000 (shtatedhjetete milion e katerqindmije) lek.

#### KORPORATA:

-kontribut ne para ne shumen prej 40.000 (dyzetmije) U.S.D., e barabarte me 4.400.000 (kater milion e katerqindmije) lek.

Kursi i kembimit per kontributet ne U.S.D. do te jete ai i aplikuar ne 5 Prill 1993, pra 110 lek per 1 U.S.D., sipas publikimit te Bankes se Shqiperise. Çdo ndryshim i mevonshem ne raportin e kembimit ndermjet U.S.D. dhe lekut shqiptar nuk do te kete asnje efekt mbi perqindjet respektive te paleve ne kapitalin shoqeror, qe percaktohen me poshte.

#### SHOQERIA SHQIPTARE

-Kontributi ne natyre i Shoqerise Shqiptare perbehet nga e drejta e kapitalizuar per te perdorur per 99 (nentedhjetete e nente) vjet nje pjese Toke ne zonen e Tiranës, e caktuar per ndertimin e fabrikes se prodhimit ne shishe te Shoqerise Joint-Venture. Palet kane rene dakort te vleresojne te drejten e perdorimit te Tokes ne 570.000 (peseqindeshatedhjetete mije) U.S.D., e barabarte me 62.700.000 (gjashtedhjetedy milion e shtateqindmije) lek, sipas kursit te kembimit te aplikuar ne 5 prill 1993, vleresim i cili eshte konfirmuar si i drejte dhe i aresyeshem nga Z. Agim Robo, jurist ne Ministrine e Bujqesise dhe te Ushqimit te Shqiperise, ne perputhje me nenin 42 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, sikurse tregohet ne aneksin F bashkelidhur. Shoqeria Shqiptare dhe Shoqeria Joint-Venture, menjehere mbas krijimit, do te neneshkruaje nje "Kontrate mbi Transferimin e te Drejtave te Perdorimit te Tokes", qe i bashkelidhet kesaj









Kontrate si Aneks G, ne baze te se ciles te drejttat eksklusive te perdorimit te Tokes do t'i kalojne Shoqerise Join-Venture sipas kushteve te parashikuara ne te.  
Kapitali total fillestar i Shoqerise Joint-Venture prej 137.500.000 (njeqindetridhjeteshtate milion e peseqindmije) lek do te ndahet ne 137.500 kuota, me nje vlere prej 1.000 lek secila, i ndare midis Paleve si me poshte:

Shoqeria Italiane:	70.400 kuota prej 1.000 lek	= 51,2 per qind
Korporata	4.400 kuota prej 1.000 lek	= 3,2 per qind
Shoqeria Shqiptare	62.700 kuota prej 1.000 lek	= 45,6 per qind

5.3 Kontributet ne para te Paleve ne Monedhe te konvertueshme ne kapitalin fillestar te regjistruar do te depozitohen ne nje llogari bankare te mbajtur ne emrin e Shoqerise Joint-Venture ne nje banke jashte Shqiperise, ne baze te nje autorizimi te leshuar nga Banka Kombetare Tregtare e Shqiperise me daten 15 Prill 1993.

5.4 Palet garantojne qe kane te gjitha te drejttat e zoterimit dhe interesat mbi pasurite materiale dhe jomateriale, te fundshme e te pafundshme qe ato te kontribuojne ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise Joint-Venture pavarsisht nga koha kur kontribuohen. Keto pasuri nuk i nenshtrohen asnje detyrimi hipotekor, obligacioni apo çdo barre tjeter. Me kalimin e ketyre pasurive Shoqerise Joint-Venture, kjo e fundit do te pretendoje ndaj Paleve kontribuese qe keto t'i transferojne Shoqerise Joint-Venture te gjitha te drejttat e zoterimit dhe interesat mbi to, te lira nga çdo detyrim hipotekor, obligacion e çdo barre tjeter.

5.5 Palet impenjohen te komplotojne fazen e dyte te projektit te Joint-Venture-it duke thirrur Asamblene e Ortakeve per te vendosur shtimin e kapitalit te Shoqerise se Joint-Venture-it ne 9.500.000 (nentemilion e peseqind mije)U.S.D. sipas kontributeve ne para te Bankes Europiane dhe kontributeve ne para e ne natyre te ACIE e TCCEC e sipas skemes se Programit te shtimit te kapitalit, lidhja H.  
Ky vendim per rritjen e kapitalit do te miratohet jo me vone se 30 nentori 1994. Kursi i kembimit dollare lek per kontributet ne para do te jete ai i fiksuar ne piken 5.1 te kesaj marreveshje.

Palet bien dakort qe t'ja besojne vleresimin e kontributeve te tyre respektive ne natyre American Appraisal Italia s.r.l., me qender ne Milano, Via Boschetti nr.1, konform neneve 63 dhe 42 te ligjit 7638, date 19 nentor 1992.

Neqoftese vleresimi i American Appraisal Italia s.r.l., konkludon qe kontributet ne natyre te ACIE dhe TCCEC-se jane me te vogla ne vlere se sa shuma e parashikuar ne lidhjen H atehere pjesa qe rezulton me e vogel nga vleresimi i kontributeve ne natyre me vleren ne lidhjen H i paguhet shoqerise ne para. Neqoftese vleresimi i American Appraisal Italia s.r.l. konkludon qe kontributet ne natyre te ACIE dhe TCCEC-se jane me te larta ne vlere se sa shuma e parashikuar ne lidhjen H atehere pjesa qe rezulton me e madhe nga vleresimi i kontributeve ne natyre me vleren ne lidhjen H transformohet ne nje hua per shoqerine, te kthyeshme, te varur dhe jo te garantuar dhe sipas modaliteteve dhe kushteve te pelqyeshme per palet.  
Ne vazhdim e ne zbatim te kesaj shtese te kapitalit, kapitali i shoqerise do te perbehet si me poshte:



ACIE	4.790.000 USD i barabarte me	50,42 % te kapitalit shoqeror
TCCEC	1.240.000 USD i barabarte me	13,05 % te kapitalit shoqeror
INVEST P:F.	570.000 USD i barabarte me	6,00 % te kapitalit shoqeror
BERZH	2.900.000 USD i barabarte me	30,53 % te kapitalit shoqeror

Si pasoja kuotat e ortakeve ndahen midis tyre si me poshte :

ACIE	526.900 kuota me vlere nominale prej 1.000 leke sejcila
TCCEC	136.400 kuota me vlere nominale prej 1.000 leke sejcila
BERZH	319.400 kuota me vlere nominale prej 1.000 leke sejcila
INVEST P:F:	62.700 kuota me vlere nominale prej 1.000 leke sejcila

ACIE garanton qe (i) te ardhurat qe i kontribohen Shoqerise i ka ne disponibilitet te plote perpara dhenies si kontribut dhe qe qe ato jane te lira nga çdo lloj barre , pengu , ipoteke e çdo detyrim tjetër e qe (ii) me aprovimin e shtimit te kapitalit te Shoqerise , kjo e fundit do te jete e vetmja pronare dhe do te kete posedim te plote mbi aktivitetet e kontribuara nga ACIE - ja .

5.6. Çdo kuote do ti jape mbajtësit te saj te drejten e nje vote .

5.7. Palet pranojne qe nevojat e punes se Shoqerise Joint Venture mund te kerkojne qe Asamblea e Ortakeve te vendose mbi shtesa te metejshme ne kapitalin e regjistruar dhe jane te ndërgjegjshme qe kuota e tyre do te zvogelohet ne rast se ata nuk do te marrin pjese ne keto ritje .

5.8. Shoqeria merr persiper te perpunoje nje plan per shpermdarjen e pijeve nepermjet magazinave te vendosura ne territor dhe te pronesisë se Kompanise Shqiptare . Ajo angazhohet te marre ne konsiderate magazina te propozuara nga Shoqeria shqiptare , te cilat mund te kontribohen nga ajo ne kapitalin e Shoqerise Joint Venture . Ne nje rast te tille bihet dakort qe ky kontribut i Shoqerise shqiptare do te rrise pjesemarrjen e saj ne Kapitalin e Shoqerise Joint Venture ne masen qe i pergjigjet vleres se magazinave siç do te biet dakort .

## 6. Organizimi dhe administrimi

6.1. Organet e Shoqerise Joint Venture do te jene : a) Asamblea e Ortakeve ; b) Keshilli Administrativ dhe c) Keshilli i Revizoreve . Perberja dhe funksionimi i ketyre organeve shoqerore dhe administrative paraqiten me hollesisht ne Statut (Aneksi B) .

### 6.2. Asamblea e Ortakeve

6.2.1. Asamblea e Ortakeve si rregull mbledhet ne seline qendrore te Shoqerise se Joint Venture - it , por mund te thirret edhe ne vend tjetër me kusht qe vendi tjetër te jete ne Itali , Austri ose Angli .

Asamblea e Ortakeve thirret nga Presidenti i Keshillit Administrativ , me kerkesen e nje administratori ose nje ortaku qe perfaqeson te pakten 10 % te kapitalit shoqeror me thirrje me shkrim te drejtuar ne adresen e paleve nepermjet telefaksit te konfirmuar me leter rekomande e

te derguar paleve ne adresen qe rezulton ne librin e ortakeve te pakten 15 dite perpara mbledhjes .

Asamblea e Ortakeve eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme .

Asamblea e zakonshme duhet te mbledhet te pakten nje here ne vit , per aprovimin e bilancit , brenda kater muajve dhe kur kerkesa te veçanta e kerkojne brenda gjashte muajsh nga mbyllja e vitit financiar .

Ne letren e thirrjes duhet te tregohet vendi , dita dhe ora e mbledhjes si dhe çeshtjet qe do te trajtohen . Ne mungese te ketyre formaliteteve ne thirrje , Asamblea e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur gjithë kapitali perfaqesohet dhe jane prezent te gjithë anetaret e Keshillit Administrativ dhe te Keshillit te Revizoreve dhe ortaket prezent pranojne te diskutojne argumentat e rendit te dites .

Asamblea kryesohet nga Presidenti i Shoqerise se Joint Venture - it , e ne mungese te tij nga Zv/Presidenti neqoftese eshte i emeruar . Ne mungese te tyre Asamblea zgjedh nje president .

Presidenti i Asamblese ndihmohet nga nje sekretar edhe jo ortak i percaktuar midis te pranishmeve . Çdo ortak qe ka te drejte te marre pjese ne Asamble mund te perfaqesohet me shkrim nga nje person i trete edhe jo ortak me kusht qe te mos jete antar i Keshillit Administrativ , anetar i Keshillit te Revizoreve dhe as nenpunes i Shoqerise Joint Venture - it .

6.2.2. Ben pjese ne kompetencat e Asamblese se Ortakeve :

(a)miratimi i bilancit vjetor ;

(b)emerimi i administratoreve , Revizoreve dhe Presidentit te Keshillit te Revizoreve ;

(c)emerimi i Presidentit te Keshillit Administrativ dhe Zv/Presidenti eventual ;

(d)percaktimi i shperblimit te administratoreve dhe revizoreve neqoftese nuk eshte percaktuar ne statut ;

(e)vendos mbi pergjegjesite e administratoreve dhe revizoreve ;

(f)vendos mbi objekte te tjera te ngjashme per administrimin e Shoqerise se Joint Venture - it te rezervuara ne kompetence te Asamblese se zakonshme prej statutit ose te derguara per shqyrtim nga administratoret ;

6.2.3. Asamblea e jashtezakonshme vendos mbi ndryshimet ne kontrate e statut . Vendos gjithashtu mbi likujdimin e Shoqerise dhe mbi emerimin e likujdatoreve .

Ortaket qe nuk pajtohen me vendimet qe kane lidhje me ndryshimin e objektit ose te tipit te Shoqerise kane te drejte te terhiqen nga Shoqeria e Joint Venture - it dhe te rimbursohen per kuotat e tyre ne proporcion me pasurine sociale ne bilancin qe rezulton ne vitin e fundit financiar .

Njoftimi duhet bere per Shoqerine Joint Venture brenda tre ditesh nga mbledhja me leter rekomande nga ortaket doreheqes qe kane marre pjese ne Asamble dhe brenda pesembedhjete ditesh nga data e regjistrimit te vendimit per ortaket qe nuk kane marre pjese ne mbledhje .

6.2.4. Votat ne Asamblene e Ortakeve llogatriten en baze te principit nje kuote nje vote . Votat mund te jepen me prokure .

6.2.5.Mbledhja e zakonshme e Asamblese miraton vendime me voten pozitive te ortakeve qe perfaqesojne me shume se 50 % te kapitalit shoqeror .







Mbledhja e jashtezakoneshme e Asamblese miraton vendime me voten pozitive te ortakeve qe perfaqesojne 75 % te kapitalit shoqeror .

6.2.6. Protokollat e mbledhjeve duhet te mbahen en shqip , italisht dhe anglisht dhe duhet te neneskruhen nga Presidenti i Keshillit Administrativ dhe nga te gjitha ortaket pjesmarres ne mbledhje dhe perbejne verbalet ligjore dhe efektive te mbledhjeve .

### 6.3. Keshilli Administrativ

6.3.1. Shoqeria administrohet nga nje Keshill Administrativ i perbere nga gjashte anetare efektive (duke perfshire Presidentin dhe Zv/Presidentin) ; Ky numer mund te ndryshoje sipas parashikimeve te statutit me kusht qe çdo pale pronare e nje pjesmarrije ne kapitalin e Shoqerise se Joint Venture - it te ruaje te drejten te emeruje nje anetar ne Keshillin Administrativ . ACIE ka ta drejten te emeruje tre anetare ; Shoqeria Shqiptare , Banka Europiane dhe TCCEC kane te drejten te emerojne nga nje anetar ; emerimet duhet te konfirmohen nga Asamblea e Ortakeve . Keshilli Administrativ zgjedh Presidentin dhe Zv/Presidentin . Gjashte anetaret e Keshillit Administrativ duhet te emerohen nga Asamblea e Ortakeve . Çdo anetar i Keshillit Administrativ do te emerohet per nje periudhe kohe te papercaktuar deri sa te rievokohet nga Asamblea e Ortakeve . Perfaqesimi ligjor i Shoqerise se Joint Venture - it i takon Presidentit te Keshillit Administrativ .

6.3.2 Keshilli Administrativ mund te delegoje kompetencat e tij nje ose me shume anetareve te tij (Administratori Delegat) , duke percaktuar kufite e delegimit . Vendimi per emerimin dhe rievokimin e Administratorit Delegat duhet te rregjistrohet ne organin kompetent .

6.3.3. Per vlefshmerine e vendimeve te Keshillit Administrativ eshte e nevojshme prezenca e shumices se administratoreve efektive . Vendimet e Keshillit Administrativ merren me shumice te thjeshte te administratoreve prezent ne mbledhje . Ne rast barazimi vendos vota e Presidentit .

Per vendimet qe i perkasin blerjes dhe / ose shitjeve te shoqerise ndermarjeve dhe / ose firmave dhe operacioneve financiare ne shumen me mbi 40 % te kapitalit shoqeror eshte e nevojshme vota pozitive e te pakten kater administratoreve.

Vota mund te jepet edhe me prokure.

Keshilli Administrativ mund te marre vendime dhe me konsensus unanim me shkrim. Ne kete rast çdo administrator duhet te shprehe voten e tij me shkrim mbi nje projekt-vendim te propozuar nga Presidenti. Vota i transmetohet Presidentit me faks dhe e konfirmuar me poste rekomande. Vendimi do te merret kur te gjitha administratoret kane shprehur mendimin e tyre te pavarur per projekt - vendimin. Presidenti duhet menjehere te informoje çdo administrator per rezultatin e votimit.

### 6.4. Administratori Delegat.

6.4.1 Keshilli Administrativ mund ti delegoje funksionet e tij nje ose me shume administratoreve delegat, nga te cilet mund te varet edhe nje Drejtor i Pergjithshem edhe ky i emeruar nga Keshilli .







6.4.2 Neqoftese eshte i emeruar Drejtori i Pergjithshem ,nen kontrollin e Adminidtratorit Delegat,kryen aktivitetin e perditshem te Shoqerise se Joint - Venture-it,konform ligjit shqiptar te zbatueshem,dispozitave te kesaj Kontrate dhe direktivave dhe vendimeve te Asamblese se Ortakeve dhe te Keshillit Administrativ.

### 6.5 Keshilli i Revizoreve.

6.5.1 Keshilli i revizoreve do te emerohet nga Asambleja e Ortakeve.Ai do te perbehet nga tre revizore kontabel.

6.5.2 Keshilli i revizoreve duhet te mbikqyre administrimin e shoqerise Joint - Venture,te veshgoje respektimin e ligjit e te Statutit ,te verifikoje mbajtjen e rregullt te llogarise se Shoqerise dhe ne se korrespondon bilanci e llogaria fitim -humbje me rezultatet ne librat e regjistrat kontabel si edhe te kontrolloje zbatimin e normave te vendosura me ligj per vleresimin e pasurise se Shqiperise.

Pervec ketyre Keshilli i Revizoreve duhet qe,te pakten çdo tre muaj,te verifikoje gjendjen e arkës dhe te vlerave e titujve te pronesise shoqerore,apo te atyre te dhena Shoqerise ne ruajtje,peng e si garanci.

Revizoret mund te procedojne ne çdo moment,edhe individualisht ,me veprime kontrolli e veshgimi.

Keshilli i Revizoreve mund t'u kerkoje administratoreve njoftime mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise apo te operacioneve te veçanta.

Rezultatet e kontroleve te bera nga revizoret duhet te regjistrohen ne librin e mbledhjeve e vendimeve te Keshillit te Revizoreve.

### 6. Rregulla perfundimtare.

6.6.1 Asambleja e Ortakeve Keshilli Administrativ,Administratori delegat dhe Keshilli i Revizoreve duhet te veprojne gjithmone ne menyre te tille qe te respektojne plotesisht parimet e zhvillimit te veprimtarise se biznesit,te perfitimit reciprok dhe te mirekuptimit e konsultimit miqesor.

6.6.2 Anetaret e Asamblese se Ortakeve e te Keshillit Administrativ mund te paguhen per shpenzimet e udhetimit e shpenzime te tjera te kryera ne menyre te aresyeshme per te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese e te Keshillit Administrativ,duke i paraqitur Shoqerise deftesat e nevojshme.


Pervec ketyre pagesave,as perfaqesuesit e Paleve ne Asamblene e Ortakeve e as zevendesit e tyre nuk do te marrin nga Shoqeria Joint -Venture asnje shperblim ose pagese per detyrat e kryera ne cilesite e mesiperme.Anetaret e Keshillit Administrativ mund te marrin shperblime per sherbimet e kryera,ne ate mase qe do te caktohet nga Asambleja e Ortakeve.

6.6.3 Çdo ortak i Shoqerise Joint Venture ka te drejte te konsultohet me regjistrat e Shoqerise dhe te ngarkoje me shpenzimet e veta,nje revizor per te kontrolluar librat e saj.

### 7.Veprimtaria financiare







7.1 Ne rast se Shoqeria Joint Venture do te kerkoje fonde financimi ne çdo etape te veprimtarise se saj ,vendimi mbi zgjedhjen e burimeve financiare dhe kushtet e financimit merret nga Keshilli Administrativ ose nga administratori delegat,ne perputhje me klauzolat e meparshme 6.3.2 e 6.3.3.

Me marrëveshje ,asnje nga Palet nuk do te jete e detyruar te garantoje hua ose kredi per Shoqerine Joint Venture ,ose te marre impenjime te tjera financiare ne emer te Shoqerise, pervec kontributeve te rena dakort ne kapital.

7.2 Per borxhet e marra per financim do te pergjigjet Shoqeria Joint Venture me pasurite e saj.

### 8. Detyrime te Paleve

8.1 Pervec detyrimeve te tjera te percaktuara ne Kontrate ,Palet marrin persiper edhe detyrimet respektive qe renditen me poshte,ne lidhje me organizimin dhe veprimtarine e Shoqerise Joint Venture.

8.2 Shoqeria italiane do te jete pergjegjese per çeshtjet e meposhtme:

8.2.1 ne menyre te vazhdueshme e te qendrueshme,t'i siguroje Shoqerise Joint Venture konsulence e mbeshtetje ne lidhje me permiresimin e zgjerimin e nje sistemi modern prodhimi, shperndarje, shitje e marketing-u;

8.2.2 te ndihmoje Shoqerine Joint Venture ne pergatitjen e funksionareve administrative e personelit tjetër ne tekniken e drejtimit qe lidhet me te gjitha aspektet e aktivitetit te kryer nga ajo;

8.2.3 te ndihmoje Shoqerine Joint Venture ne zgjedhjen e paisjeve te nevojshme ,ne instalimin e fabrikes se prodhimit ne shishe,ne zgjedhjen e levruesve,ne kontrollin cilesor te lendeve te para e produktit te gatshem si dhe ne permiresimin e teknikes se administrimit te fabrikes;

8.2.4 t'i jape Shoqerise Joint Venture konsulence e asistence ne organizimin e nje training-u te pershtatshem per te punesuarit e saj,duke perfshire organizimin e kurseve te kualifikimit ne Itali,kur kjo del e nevojshme;

8.2.5 te ndihmoje Shoqerine Joint Venture per te gjetur burime te jashtme per sigurim paisjesh e lendesh te para qe nuk mund te gjenden ne vend apo te importohet ne lek;

8.2.6 te ndihmoje ne te gjitha çeshtjet qe bihet dakort t'i besohen nga Shoqeria Joint Venture.

8.3 Korporata do te jete pergjegjese per çeshtjet e meposhtme:

8.3.1 te marre persiper te furnizojte teknologjine e nevojshme per prodhimin e Pijeve dhe te kujdeset per komercializimin e prodhimeve te Shoqerise Joint Venture.







8.3.2 ne mënyrë të vazhdueshme e konstante ,t'i siguroje Shoqerise Joint Venture konsulence e mbeshetje, lidhur me permiresimin dhe zgjerimin e nje sistemi modern prodhimi, shperndarjeje, shitjeje e marketingu.

8.3.3 te ndihmoje Shoqerine Joint Venture ne zgjedhjen e paisjeve te nevojshme , ne instalimin e nje fabrike per prodhimin ne shishe , ne zgjedhjen e furnizuesve , ne kontrollin cilesor te lendeve te para e produktit te gatshem dhe ne permiresimin e teknikave te administrimit te fabrikes ;

8.3.4. te ndihmoje ne te gjitha çeshtjet qe do te biet dakort t'i besohet nga Shoqeria Joint Venture .

8.4. Shoqeria Shqiptare do te beje tere perpjekjet e saj per te siguruar , ne intetres te Shoqerise Joint Venture , sa me poshte :

8.4.1. te gjitha autorizimet , miratimet e lejet e nevojshme qe aktivitetit prodhues te Shoqerise Joint Venture t'i sigurohet ne kohe e vazhdimisht sasia e nevojshme e ujit , elektricitetit , avullit e te gjitha utilitetet , infrastruktura e sherbimet e nevojshme , sipas çmimit te tregut ne lek ;

8.4.2. ndihmese ne percaktimin gjeografik te rrjetit te furnizuesve ;

8.4.3. te gjitha autorizimet e nevojshme per te hapur llogari rrjedhese bankare ne valute te konvertueshme (USD) ose ne lek prane Bankes se Shqiperise apo çfaredo banke tjeter shqiptare ne favor te Shoqerise Joint Venture ;

8.4.4. te gjitha vizat shqiptare , lejet e qendrimit , lejet e punes dhe vendbanime per punonjesit e huaj te Shoqerise Joint Venture e anetaret e familjeve te tyre qe mund t'i shoqerojne gjate qendrimit te Shqiperi ;

8.4.5. te bashkepunoje ne kerkimin e kandidateve te kualifikuar shqiptare per te punuar ne Shoqerine Joint Venture ;

8.4.6. te gjithë ndihmesen e duhur , duke bashkepunuar me Investitoret e huaj , per ekzekutimin e perpikte te te gjithë dispozitave te percaktuara ne Vendimin e qeverise shqiptare te dates 5.6.1993 dhe per te nxjerre nga autoritetet kompetente shqiptare te gjitha lejet , autorizimet , licencat , lutjet dhe dokumenta te tjera per te cilat duhet miratim e regjistrim ne Shqiperi , ne lidhje me krijimin dhe ushtrimin e veprimtarise nga ana e Shoqerise Joint Venture ;

8.4.7.ndihmese ne te gjitha çeshtjet e tjera qe biet dakort t'i besohen nga Shoqeria Joint Venture .

8.5. Shoqeria shqiptare do te beje te gjitha perpjekjet e saj per te siguruar qe Shoqerise Joint Venture do t'i jepet me perparesi trualli prej 30.000 metra katrore , i cili percaktohet me qarte



ne ngjyre te kuqe ne planimetrine aneks D , ne se Shoqeria Joint Venture e kerkon kete truall per qellimet e saj te prodhimit .

### 9.Llogarite bankare dhe Monedha e Konvertueshme

9.1. Shoqeria Joint Venture do t'i kryeje veprimet e terheqjes se parave dhe pagesave lidhur me aktivitetet e saj permes llogarish bankare ne lek e Monedhe te konvertueshme me banka qe kane seline ne Shqiperi , ose permes llogarish ne Monedhe te konvertueshme me banka qe kane seline jashte Shqiperise , sikurse do te miratohet nga Keshilli Administrativ dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar , duke perfshire edhe Vendimin e Qeverise Shqiptare .

9.2. Shoqeria Joint Venture do te depozitoje ne llogarine e saj ne valute te konvertueshme te gjitha shumat ne Monedhe te konvertueshme qe do te grumbulloje here pas here . Bihet dakort midis Paleve qe keto fonde ne valute te konvertueshme do te perdoren kryesisht per qellimet e meposhtme e sipas kesaj radhe perparsie :

9.2.1. pagesa per te mbuluar shpenzimet ne Monedhe te konvertueshme (duke perfshire , per shembull , pagesat per rogat e personelit te huaj , per shpenzime udhetimi , per blerjen e Lendeve baze per Pijet) si dhe per pasivet eventuale te Shoqerise Joint Venture ;

9.2.2. transferim pa vonese jashte i pjeseve te fitimit qe u takon Investitoreve te huaj sipas kuotave pjesmarse respektive si dhe i te ardhurave ne rast likuidimi (sikurse garantohet nga Vendimi i Qeverise Shqiptare) ;


9.2.3. pjesa e Monedhes se konvertueshme qe mbetet do te perdoret sikurse do te vendoset nga Administratori Delegat .

9.3. Shoqeria Joint Venture do te marre pjese ne kembime monetare dhe ne çdo transakcion tjeter te nevojshem per te kryer riatdhesimin e kapitalit ose per te zhvilluar operacionet e saj (ne menyre te veçante , por pa u kufizuar ne te , importimin e koncentratit e Lendeve baze te Pijeve , lendeve te para , paisjeve , mjeteve e pjeseve te tjera) .

### 10. Lehtesira financiare

10.1 Mbi baze te nje Vendimi te Qeverise Shqiptare te dates 5 Qershor 1992 , bashkelidhur si aneks A , Shoqeria Joint Venture dhe Investitoret e huaj do te gezojne garancite dhe lehtesirat e meposhtme :

10.2. Shoqeria Joint Venture dhe Investitoret e Huaj do te perjashtohen nga taksat doganore dhe taksat e importit mbi makinerite , paisjet , godinat e parafabrikuara , mjetet e transportit e materiale te tjera , si kontribut ne natyre ne kapitalin e Shoqerise Joint Venture apo te blera permes kontributit ne para .









10.3. Shoqeria Joint Venture dhe Investitorët e Huaj do të përjashtohen nga taksat doganore e taksat e importit mbi Pijet e gatshme të importuara përpara fillimit të aktivitetit prodhues të saj dhe përderisa ajo të prodhojë në mënyrë të mjaftueshme për tregun e brendshëm .

10.4. Shoqeria Joint Venture do të përjashtohet nga taksat doganore e të importit mbi lëndet e para dhe çdo input tjetër të nevojshëm për prodhimin e Pijeve , për një periudhë prej tre vjetësh duke filluar nga data e fillimit të prodhimit të saj .

10.5. Shoqeria Joint Venture do të përjashtohet nga taksat mbi fitimin në Shqipëri për një periudhë prej 4 vjetësh nga data e fillimit të prodhimit të saj , në përputhje me ligjin Nr.7677 , date 3.03.1993 .

### 11. Ndarja e Fitimit dhe Humbjet

11.1. Palet bien dakort që , për hir të objektivave dhe synimeve të Shoqërisë Joint Venture , nuk do të lejohet një ndarje e konsiderueshme fitimesh të paktën për pesë vjetet e para të egzistencës së saj . Për këtë arsye , fitimet do të përdoren për të financuar kryesisht zgjerimin e aktivitetit . Fitimet e Shoqërisë Joint Venture në lekë e në Monedhë të konvertueshme mund të përdoren edhe për të kryer investime të reja në shoqëri të tjera që egzistojnë në Shqipëri , për të blerë mallra e shërbime shqiptare ose mund të paguhet ortakëve në formën e dividendeve për kuotat e tyre , pas pesë vjetëve të parë të aktivitetit .

11.2. Sapo të bëhet e mundur ndarja e fitimeve neto , Shoqëria Joint Venture do të kreditojë dividendet drejtperdrejtë në llogaritë e ortakëve , në mënyrë proporcionale me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë Joint Venture . Për Shoqërinë Italiane dhe Korporatën kredia do të jetë në USD , sipas kursit të këmbimit në ditën e pagesës .

### 12. Punonjësit dhe marrëdhëniet në Pune

12.1. Numri i përgjithshëm i punonjësve që do të merren në pune nga Shoqëria Joint Venture dhe kushtet e rrethanat e kontratave të punësimit të tyre i nënshkrohen vlerësimit të administratorit delegat . Pjesa më e madhe e punonjësve të Shoqërisë Joint Venture duhet të jenë të kombësive shqiptare . Çdo kontratë kolektive do të kërkojë miratimin e Këshillit Administrativ .

12.2. Për punonjësit do të parashikohet një "training" i përshtatshëm , që do të kryhet në Shqipëri ose , nëse gjykohet e nevojshme , jashtë saj .

12.3. Trajtimet siguruese si dhe ato që lidhen me sistemin e sigurimeve shoqërore në favor të punonjësve do të kryhen në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës shqiptar .

12.4. Në masën që nuk kundërshtohet nga legjislacioni shqiptar dhe në përputhje për sa parashikohet në kontratat respektive të punës , personeli i huaj do të ketë mundësinë të parapëlqejë për të përfituar të gjitha trajtimet e sigurimeve shoqërore jashtë Shqipërisë . Personeli i huaj mund të marrë rrogë në Monedhë të konvertueshme .









### 13. Deklarime e garanci

13.1. Shoqeria shqiptare deklarom dhe i garantom Investitoret e huaj per sa me poshte :

13.1.1. Shoqeria shqiptare eshte nje person juridik i themeluar ligjerisht e qe egziston brenda rregullave sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise. Ajo ka te gjitha te drejtat e fuqite per te nenshkruar kete Kontrate e per te permbushur detyrimet qe permbahen ne te .

13.1.2. Kjo Kontrate eshte kryer nga perfaqesues ligjerisht te autorizuar te Shoqerise shqiptare dhe perben nje detyrim ligjor te vlefshem e shtrengues te saj ; Kontrata eshte detyruese ne perputhje me klauzolat e saj dhe me dispozitat ligjore shqiptare .

13.1.3. Kryerja dhe permbushja e kesaj Kontrate nga ana e Shoqerise shqiptare nuk shkel asnje dispozite te : (I) dokumentave te krijimit e te organizimit te Shoqerise shqiptare ; (II) çfaredo kontrate apo dokumenti ne te cilin Shoqeria shqiptare eshte nje pale ose , permes te cilit , mund te angazhohet ndonje pjese e pasurive te saj ; (III) çfaredo dispozite te ligjeve , vendimeve , rregullave e urdheresave te organeve qeveritare shqiptare qendrore apo lokale , te cilat kane te drejte te ushtrojne autoritet mbi aktivitetin e Shoqerise shqiptare .

13.1.4. Shoqeria shqiptare ka te gjitha te drejtat e zoterimit dhe interesat mbi sejcilen nga pasurite te lujteshme e te palujteshme qe perbejne kontributin e saj ne natyre ne kapitalin e Shoqerise Joint Venture . Keto pasuri nuk i neneshtrohen asnje detyrimi hipotekor , interesi te tretesh apo çdo lloj barre tjeter . Me kalimin e ketyre pasurive ne Shoqerine Joint Venture , kjo e fundit do te kete çdo te drejte mbi to , sipas te njejtes suate te mesiperme zoterimi te tyre , qe me pare i perkiste Shoqerise shqiptare .

13.2. Investitoret e huaj deklarojne dhe e garantojne Shoqerine shqiptare per sa me poshte :

13.2.1 Shoqeria Italiane dhe Korporata jane shoqeri te themeluar rregullisht e qe ekzistojne respektivisht ne perputhje me ligjet e Italise e te Delaware (SHBA). Ato kane te gjitha te drejtat e fuqite ligjore per te nenshkruar kete Kontrate e per te permbushur detyrimet qe permbahen ne te.

13.2.2 Kjo Kontrate eshte kryer nga perfaqesues ligjerisht te autorizuar te Investitoreve te huaj qe kane marre miratimet e nevojshme te keshillave administrative respektive dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem e shtrengues per Investitoret e huaj.

13.2.3. Zbatimi e permbushja e kesaj Kontrate nga ana e Investitoret e huaj nuk shkel asnje prej dispozitave te :

(I) dokumentave te krijimit e te organizimit te tyre ; (II) çdo kontrate apo dokumenti ne te cilin Investitoret e huaj jane pale apo permes te cilit angazhohet ndonje prej pasurive te tyre.

13.2.4 Investitoret e huaj kane te gjitha te drejtat e zoterimit e interesat mbi secilen prej pasurive, te lujteshme e te palujteshme, qe perbejne kontributin e tyre ne natyre ne kapitalin e



Shoqërisë Joint Venture. Keto pasuri nuk i nënshtrohen asnjë detyrimi hipotekor, interesi të tretësh apo çdo lloj barre tjetër. Me kalimin e ketyre pasurive në Shoqëri Joint Venture, kjo e fundit do të ketë çdo të drejtë mbi to, sipas të njejtës situatë të mësipërme zotërimi të tyre, që me parë e përkiste Investitorëve të huaj.

#### 14. Furnizimi i materialeve

14.1 Të gjitha materialet e nevojshme për prodhimin e Pijeve duhet t'u përgjigjen kërkesave të Marrëveshjes për Prodhimin në Shishe .

14.2. Sheqeri dhe ingredientet e tjera të nevojshëm për prodhimin e Pijeve , si edhe shisheet e materialet e tjera ambalazhues do të blihen brenda vendit, në vartësi të plotësimi të standarteve cilësore të përcaktuara nga Kompania dhe të sigurimit të tyre në sasi të mjaftueshme, në çmime konkurruese e kushte lehtërimi të bazuara në kontratë afatgjatë furnizimi, në lek; në të kundërt, Shoqëria Joint Venture do t'i importojë keto materiale.

#### 15. Markat tregtare të Kompanisë

15.1 Prodhimi, ambalazhimi, shpërndarja dhe shitja e Pijeve nga ana e Shoqërisë Joint Venture do të kryhen në përputhje të plotë me dispozitat e Marrëveshjes për Prodhimin në Shishe, e cila do të përfundohet midis Shoqërisë Joint Venture dhe Kompanisë dhe është e një forme të ngjashme me aneksin F.

